

UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS

RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Programi i Studimit me Karakter Profesional “Kontabilitet”

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm:

1. Prof. As. Dr. Hysen Muceku – Kryetar
2. Dr. Eugen Musta – Anëtar
3. Anxhela Toska – Studente

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES VLERËSIMI TË BRENDSHËM

Programi i studimit me karakter profesional Diplomë Profesionale “Kontabilitet”, është hapur me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 545, datë 10.09.2018¹.

Programi ofrohet nga Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës, njësi e strehuar në Fakultetin e Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, i licencuar si Fakulteti Ekonomik me VKM Nr. 255, datë 27.02.2008, dhe i riorganizuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 527, datë 04.09.2018².

Programi i studimit realizohet me 120 kredite (ECTS), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet Diplomë Profesionale në “Kontabilitet”³, referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Objektivi kryesor i këtij programi është formimi dhe aftësimi i profesionistëve me njohuri praktike mbi kontabilitetin. Ky program është i dizenuar të pajisë me dije dhe aftësi praktike brenda fushës së gjerë të financë-kontabilitetit, duke plotësuar kështu nevojat e konstatuara të tregut për specialistë në nivelin operacional dhe praktik të kontabilitetit, që do të punojnë në njësi të ndryshme ekonomike dhe organizata publike dhe jo-publike.

¹ Dokumenti mbështetës nr. 54 “UMASR Nr. 545, date 10.09.2018 “Per hapjen e programit DP Kontabilitet, UET””

² Dokumenti mbështetës nr. 54.2 “UMASR Nr. 527, date 04.08.2018 “Per riorganizmin e FETI ne FEBZH, UET”

³ Dokumenti mbështetës nr. 15 “Modeli i diplomes – DP Kontabilitet”

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (më poshtë do të quhet Raporti) është hartuar në përmbushje të detyrimeve të Universitetit European të Tiranës për akreditimin e programit Diplomë Profesionale në “Kontabiliet”.

Raporti është përgatitur nga një Grup ekspertësh i ngritur me Urdhër Administrativ të Rektorit, Nr. 15, datë 21/12/2020 në përputhje me dispozitat ligjore të MASR dhe ASCAL, si dhe me Statutin dhe Rregulloren e UET. Në përzgjedhjen e anëtarëve të Grupit është mbajtur parasysh kompetenca profesionale, përvoja mësimdhënëse, aftësitë analizuese, mundësitë për mbledhjen dhe për përpunimin e informacionit për të kryer një vlerësim të paanshëm, shkalla e nevojshme të njohjes së institucionit, si dhe profili individual profesional. Në punën për hartimin e Raportit, Grupi ka vepruar me një ndarje pune, detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë për secilin anëtar. Në konsultim me personelin akademik dhe studentët, anëtarët e Grupit në analizën e tyre kanë vënë theksin në përmbytjen akademike të programit, në cilësitë e personelit akademik përgjegjës për realizimin e tij, në vlerësimin e infrastrukturës dhe mjedisit në dispozicion, si dhe në parametra të tjerë me rëndësi për procesin e akreditimit.

Grupi është bazuar në kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, aktet ligjore e nënligjore përkatëse, në mënyrë të veçantë udhëzimet e ASCAL-it, si edhe ka shfrytëzuar dokumentet e brendshme të UET-it. Grupit i janë vënë në dispozicion dhe ka shfrytëzuar në mënyrë racionale të dhënat që nevojiten për procesin e akreditimit.

Ecuria e procesit është ndjekur nga Përgjegjësi i Departamentit dhe Zyra e Standardeve dhe Cilësisë, të cilët kanë asistuar GVB dhe kanë koordinuar procesin e mbledhjes së të dhënave. GVB ka zhvilluar takime të herëpashershme fizike dhe on-line me të gjithë aktorët e përfshirë në këtë proces, takime të fokusuara në orientimet e nevojshme në lidhje me procesin e hartimit të raportit të vlerësimit të brendshëm, udhëzuesit dhe formatet për shkrimin e raportit.

Vlerësimi i Programit të Studimit me karakter profesional në “Kontabilitet”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi me karakter profesional në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij dhe në përputhje me nevojat e kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Programi i studimit me karakter profesional në Kontabilitet i ofruar nga UET është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit si dhe me strategjinë e tij për zhvillim. Ky program studimi plotëson profilin dhe ofertën akademike të Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit. Programi përgatit specialistë të aftësuar për të kryer veprimtari praktike në fushën e kontabilitetit, duke iu përgjigjur kërkesave aktuale dhe perspektive të tregut të punës në Shqipëri.
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit duhet të përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe të demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Në statutin dhe rregulloren e UET-it janë përcaktuar qartë vizioni, misioni dhe objektivat strategjike ⁴ të institucionit dhe ato shërbejnë si bazë në hartimin e programeve të studimit. Programi me karakter profesional në Kontabilitet është hartuar dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre direktivave.
Kriteri 3. Programet e studimeve ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit, si dhe fushën akademike të njësisë kryesore/kolegjit profesional dhe atë të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit.	Drejtimit prioritar akademike të UET-it janë të përcaktuara në dokumentet themelore të institucionit. Në këto dokumente shprehet angazhimi në ruajtjen e profilizimit të tij kryesor në shkencat ekonomike, financiare, menaxheriale, jurisprudencës, shkencave politike e sociale, edukimit, sporteve, TIK-ut, arkitekturës, inxhinierive, komunikimit, shkencave mjekësore teknike, etj., por mbetet i hapur ndaj diversifikimit të ofertës së tij akademike e shkencore dhe në drejtime të tjera që vlerësohen se kërkohen nga tregu i punës dhe UET ka mundësitë njerëzore e financiare për t'i aplikuar ato ⁵ . Ndërkohë që, në përgjigje të kërkesave të ardhura nga studentë, apo nga tregu i punës, por edhe bazuar në studimet e tregut, në dekadën e tij të dytë, Institucioni ka vendosur zgjerimin e fushave të studimit, në të cilat ofron programe studimi.
Kriteri 4. Propozimi, hartimi dhe realizimi i programit të studimit me karakter profesional mbështetet në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.	Propozimi, hartimi dhe realizimi i programit të studimit është mbështetur në studimin e tregut kombëtar të punësimit si edhe në vlerësimin e nevojave për arsimim të rinjve që nuk mund të ndjekin arsimin e lartë, niveli parë, për shkak të mos plotësimit të kushtit të notës mesatare.
Kriteri 5. Gjatë realizimit të programit të	Departamenti përgjegjës për programin e studimit: Diplomë

⁴ Dokumenti mbështetës nr. 2 – Statuti, neni 6; nr. 3.3. Plani Strategjik 2021-2025 (Ref. Nr. 3.3); nr.5 “Rregullore e UET”

⁵ Dokumenti mbështetës nr. 3 dhe nr. 3.3 - Plani Strategjik 2015-2020; 2021-2025, Objektivat strategjike, pika 3

<p>studimit, nga pranimi në diplomim dhe pas daljes së studentëve në punë, zhvillohen studime periodike mbi tregun e punës, ndryshimet përkatëse dhe punësimin e studentëve.</p>	<p>Profesionale në Kontabilitet ka vazhdimisht nën vëzhgim dhe analizë dinamike të tregut të punës në vend dhe më gjerë. Njëpërmjet strukturave të ngritura si: Zyra e Këshillimit të Karrierës, Bordi i Tregut të Punës⁶ dhe kontaktet e vazhdueshme me institucione dhe bizneset me të cilat janë lidhur edhe kontrata bashkëpunimi⁷, arrihet të merret një informacion koherent mbi nevojat e tregut të punës dhe këto <i>input</i>-e pasqyrohen më pas në analizën e kurikulës mësimore të programeve të studimit, si dhe në syllabuset e secilës lëndë, të cilat rishikohen në bazë vjetore.</p> <p>Duke qenë se ky program akreditohet për herë të parë, statistikave të punësimit të të diplomuarve në të janë ende të pakta (deri tani janë diplomuar vetëm 2 studentë nga të cilët 1 është punësuar)⁸, por në vazhdim, duke ndjekur praktikën tashmë të afirmuar të institucionit⁹ ky proces do të monitorohet dhe të dhënat e mbledhura do të jenë subjekt i analizës dhe reflektimit.</p>			
<p>Kriteri 6. Studimet paraprake dhe periodike të tregut të punës për programet me karakter profesional duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Lidhja e ngushtë që institucioni mban me botën e biznesit si dhe konsultat, statistikave dhe analizat e bëra në bashkëpunim me Bordin e Tregut të Punës ofrojnë një burim të besueshëm të informacionit lidhur me nevojat, kërkesat dhe dinamikën e tregut të punës. Ky informacion ka shërbyer dhe shërben si bazë për hartimin dhe më pas azhurnimin e vazhdueshëm të programit të studimit profesional DP në Kontabilitet.</p> <p>Gjithashtu Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit ndjek ecurinë dhe mban statistika mbi punësimin dhe zhvillimin profesional të studentëve aktiv dhe atyre tashmë të diplomuar.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.2 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, dhe në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron</p>	<p>Ndarja e detyrave dhe përgjegjësi në hartimin, mbikëqyrjen</p>

⁶ Dokumenti mbështetës nr. 12 “Mbi funksionimin e Zyres së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit”; nr. 12.1, 12.2 “Bordi i tregut të punës 2018-2019 / 2019-2020”, nr. 12.3 “Poster_panairi i punës 2018 dhe 2019”, nr. 12.4 “Realitetet e reja të post-covid në tregun e punës 2020”, nr. 12.5 “Bashkëpunime me biznesin – projekti 500+”

⁷ Dokumenti mbështetës nr. 32 - Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikën profesionale; Dokumenti mbështetës nr. 34, 34.1-34.9

⁸ Dokumenti mbështetës nr. 29 - Tabelë përmbledhëse për punësimin real të studentëve

⁹ Dokumenti mbështetës nr. 12 - Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyres së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit

<p>marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësisve respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>dhe mbarëvajtjen e programit është e përcaktuar në rregulloret dhe aktet e tjera të brendshme të institucionit¹⁰. Detyrat dhe përgjegjësitë ndahen midis njësisve të ndryshme, por pesha kryesore mbulohet nga njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit. Në aktet rregullatore janë të përcaktuara qartë roli i përgjegjësit të njësisë bazë, përgjegjësit të grup-lëndëve/koordinatorit të programit sikurse dhe ato të titullarit të lëndëve specifike¹¹.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave të procesit mësimor, formimin teorik e praktik të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie afatgjata e të qëndrueshme bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, me punëdhënës vendës, aktorë të biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>GVB vlerëson se janë vendosur marrëdhëniet e bashkëpunimit me aktorë dhe institucione vendase, ku realizimi i praktikave profesionale mbetet një ndër komponentët kryesor, së bashku me krijimin e lidhjeve midis universitetit dhe aktorëve të tregut të punës në funksion të punësimit të studentëve por edhe për të qenë më pranë nevojave të tregut të punës dhe reflektimit të tyre në programin e studimit¹².</p>
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Departamenti i Ekonimisë dhe Financës, në përputhje dhe me planin e zhvillimit të programit¹³, ka hartuar raportin analitik për përfitimet nga marrëveshjet kontraktuale të bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve. Përfaqësues të kompanive të kontraktuara janë anëtarë të Bordeve të Punës pranë Departamenteve në UET, ky bashkëpunim synon të kontribuojë në internshipet e studentëve, bordet e punës, leksionet e hapura dhe vizitat në kompani.¹⁴</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>UET-i në nivel institucional, por edhe nën nismën apo nevojat e fakulteteve dhe departamenteve të tjera, ka lidhur dhe vazhdon të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me kompani dhe institucione publike e private në vend, ku studentët kryejnë vizita, praktika, apo internshipe e cila bazohet mbi procedurat e zhvillimit të praktikave profesionale të rregulluara nëpërmjet akteve të brendshme, në të cilat janë parashikuar si procedurat që duhet të ndiqen ashtu edhe roli i aktorëve dhe njësisve të ndryshme të përfshira në këtë proces¹⁵. Gjithashtu në kuadër të lëndës Praktikë & Zhvillim karriere studentët kanë mundësinë të takohen dhe të marrin kontakt të drejtpërdrejt me përfaqësues të biznesit të cilët marrin pjesë në këto seanca si të ftuar për të ndarë eksperiencën e tyre me studentët.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe</p>	<p>Institucioni nëpërmjet zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj studentit aplikon praktika të suksesshme në</p>

¹⁰ Dokumenti mbështetës nr. 5 - Rregullore e Universitetit European të Tiranës, Neni 16, 17, 18, 21, 22; Dokumenti mbështetës nr. 6 - F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit; Dokumenti mbështetës nr. 36 - Vendim për emërimin e kordinatorëve të programeve të studimit

¹¹ Dokumenti mbështetës nr. 39 - Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës;

¹² Dokumentet mbështetëse nr. 32 - Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit; nr. 34.1 – 34.9 Marreveshjet konkrete.

¹³ Dokumenti mbështetës nr. 4 “Plani strategjik i zhvillimit të programit”

¹⁴ Dokumenti mbështetës nr. “Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit”

¹⁵ Dokumenti mbështetës nr. 32 - Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikat profesionale; nr. 34.1 – 34.9 Marreveshjet konkrete.

Dokumentet mbështetëse nr. 32.2 - 32.1. Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale;

punësimi të studentëve.	mbështetje të punësimi të studentëve duke krijuar lidhje të vazhdueshme midis universitetit dhe biznesit siç edhe dëshmohet në marrveshjet e shumta të bashkëpunimit që institucioni ka lidhur. Gjithashtu nëpërmjet iniciativave të ndryshme brenda dhe jashtë universitetit studentët stimulohen dhe asistohen në mentorim përsa i përket mbështetjes së ideve të tyre sipërmarrëse.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi dhe Kuadrin Evropian e Shqiptar të Kualifikimeve për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimeve janë të organizuara në lëndë/module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit është organizuar në lëndë dhe module, të vlerësuara me kredite, në përputhje me udhëzimet e MASR, me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve ¹⁶ . Programi shtrihet në 2 vite akademike për një total prej 120 kredite ECTS. ¹⁷
Kriteri 2. Programet e studimeve me karakter profesional synojnë përfundimin e njohurive gjithë përfshirëse të specializuara teorike dhe praktike brenda një fushe punësimi në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	Programi i studimit Diplomë Profesionale në Kontabilitet synon të pajisë studentët me këto aftësi kyçe: <ul style="list-style-type: none"> a. Zgjerim dhe specializim të koncepteve bazë të financës dhe nënfushave të saj, si: kontabiliteti, b. Njohje dhe zbatim i parimeve dhe standardeve bazë mbi të cilat ushtrohen veprimtaritë e kontabilitetit, c. Zhvillimin e njohurive mbi bazën e praktikave profesionale, kryesisht praktika vendase bazuar në standarde dhe praktika profesionale, d. Aftësimi për të kontabilizuar dhe raportuar transaksionet e përditshme të njësive ekonomike, aftësim për të përgatitur pasqyra e raporte financiare, buxhetime, etj.
Kriteri 3. Programet e studimit me karakter profesional synojnë pajisjen e studentëve me një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese probleme të karakterit profesional praktik.	Për t'i ardhur në ndihmë kontabilistëve të rinj, programi Diplomë profesionale në Kontabilitet fokusohet më tepër në praktikën vendase, ku i tërë programi synon të jetë si një paketë e plotë, e cila shërben si guidë në veprimtarinë e tyre, por jo vetëm. Kështu, programi ka integruar dhe aspekte teorike, praktike dhe ligjore që lidhen me aplikimin e profesionit të financierit dhe kontabilistit, duke pajisur në këtë mënyrë të

¹⁶ Ligji 80_2015_Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH; VKM nr. 41, dt. 24.1.2018 – Elementët e programeve të studimit; VKM Nr. 531 date 11.09.2018_Për miratimin e Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë

¹⁷ Dokumenti mbështetës nr. 14- Kurrikula e programit DP Kontabilitet, Dokumenti mbështetës nr. 14.1 - Plani mesimor DP Kontabilitet, Dokumenti mbështetës nr. 14.2 - Plani mesimor i ndarë sipas veprimtarive formuese

	diplomuarit në këtë program me aftësi gjithpërfshirëse në fushën e kontabilitetit që do t'i ndihmojnë ato të zgjidhin sa më mirë problematikat e hasura në praktikimin e profesionit. ¹⁸			
Kriteri 4. Programet e studimit me karakter profesional synojnë zhvillimin e kompetencave për menaxhimin dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive profesionale dhe orientimin e duhur në situata të ndryshme e të ndryshueshme.	Ky program studimi është dizenuar të pajisë me dije dhe aftësi praktike kryesisht në nën-disiplinat e kontabilitetit brenda fushës më të gjerë të financë – kontabilitetit. Me këtë synim, programi i këtij cikli dyvjeçar kombinon dijet bazë teorike mbi kontabilitetin, bazën e njohurive ekonomike dhe financiare me dije dhe aftësi praktike në lidhje me profesionin e kontabilistit dhe fiancierit.			
Kriteri 5. Institucioni/njësia kryesore/kolegji profesional dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të organizimit, strukturës akademike dhe numrit e shkallës së kualifikimit të stafit akademik.	<p>Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës zhvillon të gjitha veprimtaritë e tij në përputhje legjisacionin në fuqi dhe në përmbushje të standardeve të cilësisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Departamenti është njësi bazë e Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, Fakultet i cili është krijuar me VKM Nr. 255, datë 27.02.2008 dhe riorganizuar me Urdhër të Ministrit Nr. 527, datë 04.09.2018. UET është institucion i akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 12, datë 07.04.2017, si dhe Vendim Nr. 46, datë 05.07.2019.</p> <p>Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës përbëhet nga 14 anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë, nga të cilët: 1 Prof.Dr., 3 Prof.Asoc.Dr., 4 Dr. dhe 6 asistent lektorë. Personeli akademik me kohë të pjesshme përbëhet nga 1 anëtar, me gradë shkencore Prof.Dr. Raporti personel akademik me kohë të plotë kundrejt atij me kohë të pjesshme është 14:1.¹⁹ Pedagogët me gradë shkencore dhe me titull angazhohen kryesisht në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve. Personeli i ri akademik, me më pak përvojë në fushën e mësimdhënies (doktorantë) ngarkohet kryesisht me zhvillimin e seminareve në ciklin e parë të studimeve.</p>			
Kriteri 6. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.	<p>Programi i studimit Diplomë Profesionale në Kontabilitet ka si objektivi të pajisë studentët me këto aftësi kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. Njohuri dhe koncepte bazë të fushës së studimit; b. Aftësi drejt një profesioni, apo licence profesionale; c. Formim qytetar të përgjithshëm; d. Aftësi bazë për punë kërkimore aplikative; e. Aftësi të përgjithshme praktike, aplikative; f. Aftësim për promovim personal; g. Projekt profesional pa origjinalitet kërkimor, por që dëshmon aftësitë e tij brenda profesionit të zgjedhur.²⁰ 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

¹⁸ Dokumente mbështetëse nr. 19 – Silabuset e lëndëve të ofruara

¹⁹ Dokumenti mbështetës nr. 23 - Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse; Aneks – Tabela përmbledhëse 1 dhe 2

²⁰ Dokumenti mbështetës nr. 7 – Rregullore e programit të studimit DP në Kontabilitet

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi II.1	
Programet e studimeve me karakter profesional janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të këtij niveli dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programet e studimit të ciklit të parë, përbajnë dhe japin informacionet e nevojshme për objektivat formues, rezultatet e pritshme të të nxënit, organizimin, strukturën, përbajtjen, fushat e mundshme të punësimit apo të dhëna reale të punësimit të studentëve të diplomuar në këto programe.</p>	<p>Informacioni në lidhje me organizimin, strukturën dhe përbajtjen e programeve të studimit, gjenden të publikuara në rrjetin e brendshëm kompjuterik të Universitetit: DOKUMENTE UET. Departamenti dhe çdo anëtar i personelit akademik dhe administrativ, ka akses të plotë jo vetëm te Statuti e rregullorja e institucionit, por edhe te kurrikula e programeve të studimit, planet mësimore, silabuset, rregulloret e programeve të studimit, si dhe aktet e tjera rregullatore të UET. Studentët e programit të studimit marrin të gjithë informacionin e nevojshëm, lidhur me programin e studimit dhe lëndët e modulet e tij. Silabuset dhe materialet e leximit për secilën lëndë hidhen edhe në sistemin LMS.²¹ Të dhënat e detajuara për programin e studimeve gjenden edhe në faqen e internetit të universitetit.</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit janë të organizuara në module/lëndë e aktivitete formuese, të vlerësuara me kredite, të ndara në vite e semestra e që janë në përputhje me përcaktimet vendëse e evropiane në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit është organizuar në lëndë dhe aktivitete formuese, të vlerësuara me kredite, në përputhje me udhëzimet e MASR, me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të transferimit dhe Grumbullimit të Kreditve. Lëndët e këtij programi janë të vlerësuara me nga 4 deri në 6 kredite (ECTS), duke bërë që në total ky program studimi me karakter profesional të këtë 120 ECTS²².</p> <p>Programi është i strukturuar si edhe i organizuar në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi aktualisht. Konkretisht programi është riorganizuar në pesë kategori disiplinash²³:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. A - Disiplina të Formimit të Përgjithshëm (Bazë) 18% 2. B - Disiplina të Formimit Karakterizues të Programit 48% 3. C- Disiplina të Formimit Profesional 15%

²¹ Dokumenti mbështetës nr. 46.1 - Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS; <https://uet.edu.al/new/wp-content/uploads/2019/01/DP-Kontabilitet.pdf>

²² Dokumenti mbështetës nr. 14 “Kurrikula e programit -DP Kontabilitet”; 14.1 “Plani mësimor i programit-DP Kontabilitet”; nr. 14.2 “Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese”

²³ Referuar “Rregullore e programit të studimit DP Aplikime Informatike” (Ref. Nr. 7)

	<p>4. D - Veprimtari Formuese 15%</p> <p>5. E - Punimi i Diplomës 4%²⁴</p> <p>Pesha që zë secila kategori e veprimtarive formuese (A-E) brenda programit të studimit me karakter profesional DP në “Kontabilitet” është përcaktuar në VKM Nr. 879, dt. 18.12.2019, pra më shumë se një vit pas licencimit të programit të studimit.</p> <p>Programi i studimit është licencuar me Urdhër të MASR Nr. 545, dt. 10.09.2018, pas vlerësimit pozitiv nga ekspertët. Për rekomandimet e lëna në hapjen e programit, Departamenti i Ekonomisë dhe Financës ka marrë masa plotësimin e tyre duke strukturuar silabuset e lëndëve sipas formatit të UET i hartuar duke u bazuar në shtojcën nr. 2 të VKM Nr. 41/2018, të ndryshuar, në kuadër të rekomandimit për plotësimin në përmbajtje të komponentëve të programit me karakter profesional.</p> <p>Gjithasthu janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe aktorët të biznesit të interesuar për këtë fushë, të cilat janë shfrytëzuar për përmbushjen e objektivave të programit dhe në funksion të zhvillimit të praktikave profesionale.²⁵</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit, vlerësimin e dijeve, aktivitete specifike etj.</p>	<p>Plani mësimor i program jep informacion të plotë në lidhje me ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore në auditor dhe orë punë individuale për çdo lëndë të programit. Ndërkohë në rregulloren e UET dhe rregulloren e programit të studimit përcaktohen rregullat për nivelin e frekuentimit të mësimin (60%) në rastin e programeve me karakter profesional, dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve dhe sistemin e vlerësimit, zhvillimin e provimeve, etj.²⁶</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët e aktivitetet formuese të programit të studimit.</p>	<p>Informacioni i detajuar për secilën lëndë të programit të studimit paraqitet në silabusin e detajuar, i cili miratohet përpara fillimit të semestrit nga përgjegjësi i grupit mësimor dhe përgjegjësi i departamentit. Syllabuset²⁷ janë të hartuar sipas Shtojcës nr. 3 – Programi i Lëndës (ndryshuar me VKM nr. 879, datë 18.12.2019) e VKM-s Nr. 41, datë 24.01.2018 dhe Dokumenti A.III. Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe përdorimit të literaturës²⁸</p>
<p>Kriteri 5. Struktura dhe organizimi i programit të studimit është mjaftueshmërisht fleksibël për të mundur formimin e studentëve përgjatë programit dhe në përshtatje me punësimin.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit, pika 10, parashikohet se programi i studimit, plani mësimor, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese, që ofrohen në këtë program dhe kreditet për secilën prej tyre rishikohen në mënyrë periodike. Rishikimi bëhet në konsultim me Bordet e Tregut të Punës, si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës, dinamikave të brendshme.²⁹ Sikurse u përmend edhe më sipër, silabuset përditësohen dhe miratohen përpara fillimit të çdo semestri, për të garantuar</p>

²⁴ Dokumenti mbështetës nr. 14.2 - Plani mesimor i ndare sipas veprimtarive formuese

²⁵ Dokumenti mbështetës nr. 18 - Adresimi i rekomandimeve te hapjes

²⁶ Dokumenti mbështetës nr. 14 - Kurrikula e programit DP Kontabilitet

Dokumentit mbështetës nr. 14.1 – Plani mësimor DP Kontabilitet

Dokumentit mbështetës nr. 7 - Rregullorja e programit, pika 5 dhe 6

²⁷ Dokumenti mbështetës nr. 19 – Syllabuset e lëndëve

²⁸ Dokumenti mbështetës nr. 39 - Dokumenti A.III. Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe përdorimit të literaturës

²⁹ Dokumenti mbështetës nr. 7 – Rregullore e programit të studimit

	përmirësimin dhe përditësimin e informacionit për studentët.			
Kriteri 6. Mësimi praktik dhe i elementeve të punës konkrete u është dhënë vendi dhe pesha e duhur në strukturë, vlerësim dhe rivlerësim.	<p>Programi i studimit me karakter profesional në Kontabilitet është hartuar me orientim drejt aspektit praktik të aplikueshëm të njohurive dhe aftësive me të cilat studenti pajiset gjatë ciklit të studimit. Ky orientim bazohet dhe në dokumentacionin rregullator të programeve me karakter profesional, praktikës profesionale³⁰ dhe pasqyrohet si në kurrikul, ashtu dhe në syllabuset e lëndëve të këtij programi.</p> <p>Kontrolli i vazhdueshëm, detyrat praktike gjatë seminarit, rrisin mundësinë për të kuptuar nëse studentët po i arrijnë objektivat mësimore. Për të pasur një transmetim dhe përvetësim sa më të mirë të njohurive procesi mësimor zhvillohet me leksione, me seminare, leksion/seminare, me detyra praktike dhe me detyra kursi, punim diplomë, provim të përgjithshëm përfundimtar, etj. Kontrolli i dijeve³¹ është i vazhdueshëm, përgjatë gjithë semestrit, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të identifikojnë mangësitë dhe t'i plotësojnë ato përpara përfundimit të semestrit.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Struktura, plani mësimor dhe shpërndarja lëndore e programeve të studimit me karakter profesional, është në përputhje me objektivat formuese, rezultateve të të nxënës sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve dhe kërkesave të tregut të punës për këto programe.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Emërtimi, struktura dhe shpërndarja e në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore është në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	<p>Programi i studimit DP në Kontabilitet është hartuar në përputhje me kërkesat e ligjit për arsimin e lartë Nr. 80/2015, (neni 72). Programi ofrohet me 120 ECTS, me kohëzgjatje normale 2 vite akademik dhe në përfundim lëshohet “Diplomë profesionale” në Kontabilitet. Në rregulloren e programit të studimit jepet informacion i plotë mbi organizimin, strukturën, përmbajtjen, objektivat formuese, rezultatet e pritshme, fushat e punësimit, etj.³²</p> <p>Disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në këtë program studimi janë të organizuara në 5 kategori, nga A – ja deri te E – ja. Në kategorinë A bëjnë pjesë disiplina të formimit të përgjithshëm/bazë, në kategorinë B disiplina të formimit karakterizues të programit, në kategorinë C disiplina të formimit profesional, në kategorinë D veprimtari formuese për njohje të gjuhëve të huaja, aftësi kompjuterike dhe praktika profesionale. Në kategorinë E janë Detyrime</p>

³⁰ Dokumenti mbështetës nr. 32.1 - Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale;

³¹ Referuar “Plani mësimor I programit-DP Aplikime Informatike” (Ref.14.1); ANEKS: Tabelat përmbledhëse – Tabela Nr. 15 “Format e kontrollit të njohurive” (Ref. Nr. 0.2)

³² Dokumenti mbështetës nr. 7 – Rregullore e programit të studimit DP në Kontabilitet

	përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e projekti aplikativ profesional ose me provimin përfundimtar. Përfundimi me sukses i programit të studimit e çon studentin në tregun e punës ose i jep mundësi atij për njohjen/transferimin e krediteve të grumbulluara gjatë studimeve profesionale të larta në studimet universitare të ciklit të parë ³³ .
Kriteri 2. Emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit, rezultateve të pritshme të të nxënit dhe punësimin e studentëve.	Struktura, emërtimi si dhe shpërndarja e ngarkesës mësimore në katër semestra të shtrirjes 2 vjeçare të programit është e balancuar. Shpërndarja e lëndëve ndjek logjikën e avancimit nga lëndët bazë të formimit të përgjithshëm, në lëndë me karakter praktik. Shpërndarja e krediteve nëpër vite është normale, total në vitin e parë 63 ECTS, total në vitin e dytë 57 ECTS. ³⁴ Orët e studimit dhe kreditet përkatëse për secilën lëndë dhe në tërësi, janë strukturuar bazuar mbi udhëzimet dhe legjislacionin në fuqi duke garantuar një ngarkesë të përballueshme dhe eficiente për të stimuluar studentët në arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënit. ³⁵
Kriteri 3. Plani mësimor, natyra dhe emërtimi i moduleve/lëndëve, syllabuset e moduleve e të aktiviteteve formuese janë informuese dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara.	Në hartimin e planit mësimor të programit të studimit DP në Kontabilitet janë respektuar të gjithë kriteret e kërkuara në ligjet, VKM-të dhe rregulloret përkatëse të institucionit. Gjithashtu në përgatitjen e moduleve/lëndëve, syllabuseve të tyre dhe veprimtarive të tjera formuese është punuar me një kujdes që ato të jenë sa më informuese. ³⁶
Kriteri 4. Ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimin në praktikë/punë konkrete në profesion.	Lëndët në programin e studimit janë përgjithësisht me 6 kredite ³⁷ , me ndarje 2.5 kredite leksione (teori) dhe 3.5 kredite seminar/ushtrime+laborator (praktikë). Gjatë zhvillimit të lëndëve, pedagogët fokusohen në rastet dhe ilustrimet praktike pasi kjo përkon dhe me karakterin profesional të programit të studimit. Parimi themelor i ndërtimit të programeve është parimi i rrathëve, i cili ka si qëllim lehtësojë përshtatjen e studentëve që vijnë nga programe të ndryshme studimi, brenda ose jashtë UET-it, në një program studimi të një cikli universitar; plotësimi i njohurive për studentët që i përfundojnë studimet në njërin nga ciklet dhe nuk vazhdojnë më tej studimet e tyre. ³⁸ Struktura e programit, emërtimet dhe përmbajtja e lëndëve, ngarkesa e tyre në kredite, raporti teori praktikë janë në përputhje me orientimin e programit me karakter profesional ³⁹ Duhet theksuar fakti se programi i studimit me karakter

³³ Dokumenti mbështetës nr. 53 – Ligji 80/2015 Per arsimin e larte ne RSH (Neni 72, pika 2)

³⁴ Dokumenti mbështetës nr. 14 “Kurrikula e programit – DP Kontabilitet

³⁵ Dokumenti mbështetës nr. 14.1 – Plani mësimor i programit DP në Kontabilitet

³⁶ Dokumenti mbështetës nr. 14 – Kurrikula e programit DP në Kontabilitet
Dokument mbështetës nr. 14.1 – Plani mësimor i programit DP në Kontabilitet

Dokument mbështetës nr. 14.2 - Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - DP Kontabilitet

Dokument mbështetës nr. 19 – Syllabuset e lëndëve

³⁷ Dokumenti mbështetës nr. 14 – Kurrikula e programit DP në Kontabilitet

³⁸ Dokumenti mbështetës nr. 39 – Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës”, Pika A.III.4

³⁹ Referuar “Plani mësimor i programit -DP Aplikime Informatike” (Ref. Nr.14.1)

	<p>profesional në “Kontabilitet” me kurrikulën e propozuar nga UET, u miratua në Shtator 2018⁴⁰ për të filluar aktivitetin akademik. Gjatë kësaj periudhe UET nuk ka patur detyrim ligjor për të përcaktuar raportet në përqindje si në këtë kriter. Edhe kurrikulat, për vitin akademik 2019-2020 janë miratuar përpara hyrjes në fuqi të VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, “Për disa ndryshime në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL””</p> <p>Gjithsesi, nga analiza e përmbajtjes së moduleve dhe aktiviteteve të ofruara nga kurrikula e programit rezultojnë se raporti mes formimit teorik dhe praktik është 51:49 (nëse përllogaritet në bazë të krediteve, dhe po aq nëse përllogaritet në bazë të orëve në auditor), në të dyja rastet në favor të formimit praktik.⁴¹</p> <p>Rreth 21% (24.5) e programit i ofron studentit aftësim praktik/punë konkrete në profesion, pasqyruar në relacion (evidenca mbështetëse me nr. 14.3 “Plani mësimor sipas veprimtarive formim teorik_praktik”)⁴²</p>			
<p>Kriteri 5. Klasifikimi sipas aktiviteteve formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe orientimin e studentit drejt studimeve të mëtejshme dhe/ose në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi i studimit është i organizuar në mënyrë të tillë që studenti të marrë formimin e duhur, kryesisht praktik, për arritjen e objektivave profesionale, me qëllim kualifikimin dhe punësimin, në fushën e financës.</p> <p>Programi synon të transmetojë aftësi dhe shprehi te studentët për t’iu përgjigjur kërkesave të tregut të punës, mbështetur edhe në lidhjet e krijuara me partnerët konkretë të tregut të punës të përfaqësuar në Bordin e Tregut të Punës të Departamentit, si dhe përmes programit 500+.⁴³ Gjithashtu, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi, studenti mund të transferojë studimet⁴⁴ edhe në një program të ciklit të pare.⁴⁵</p> <p>Megjithëse parashikimet e kuadrit ligjor nuk kanë fuqi prapavepruese, konstatohet se në program ka një ngarkesë më të madhe lëndësh teorike, dhe me fokus të reduktuar drejt aftësimi praktik. Në hartimin e programit mësimor dhe kurrikulave për vitin akademik 2021-2022 ky raport do të kihet parasysh.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi II.3
Përmbajtja e lëndëve, moduleve dhe formave të tjera formuese të programeve të studimit me karakter profesional është në përputhje me objektivat formuese, rezultatet e të nxënit dhe kërkesat e

⁴⁰ Dokumenti mbështetës nr. 54 - URDHER Nr.545, date 10.09.2018 Per Hapjen e Programit te studimit me karakter profesional ne Kontabilitet , ne UET

⁴¹ Dokumenti mbështetës nr. 14.3 - “Plani mësimor sipas veprimtarive me karakter teorik v.s. praktik

⁴² Dokumenti mbështetës nr. 14.3 - “Plani mësimor sipas veprimtarive me karakter teorik v.s. praktik

⁴³ <https://uet.edu.al/new/programi-500/?lang=sq>

⁴⁴ Dokumenti mbështetës nr. 7 – Rregullore e programit të studimit, pika 9

⁴⁵ Ligji 80/2015 , Neni 72, pika 2

tregut të punës për këto programe	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përmban të dhëna të plota mbi përmbajtjen e moduleve/lëndëve të formimit teorik e praktik dhe aktiviteteve të tjera të formimit sipas strukturës e planit të studimit.</p>	<p>Disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në këtë program studimi janë të organizuara në 5 kategori, nga A – ja deri te E – ja. Në kategorinë A bëjnë pjesë disiplina të formimit të përgjithshëm/bazë, në kategorinë B disiplina të formimit karakterizues të programit, në kategorinë C disiplina të formimit profesional, në kategorinë D veprimtari formuese për njohje të gjuhëve të huaja, aftësime kompjuterike dhe praktika profesionale. Në kategorinë E janë Detyrime përmblylëse, që lidhen me përgatitjen e projektit aplikativ profesional ose me provimin përfundimtar. Programi i studimit dhe plani mësimor i bashkëlidhet si shtojcë rregullore mësimore dhe publikohen çdo fillim viti akademik. Programet e studimit të detajuar me lëndët dhe modulet që përmban, i jepet studentit që në momentin e regjistrimit. Gjithashtu gjendet edhe në faqen e internetit të UET. Në fillim të çdo semestri, studentëve u vihet në dispozicion programi i të gjitha lëndëve që do të zhvillohen, ku janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar, ngarkesa, temat për çdo javë mësimore, literatura e detyrueshme dhe e rekomanduar për secilën temë, format e kontrollit dhe vlerësimit, niveli i detyrueshëm i frekuentimit të lëndës dhe literatura bazë dhe ajo e rekomanduar.⁴⁶</p>
<p>Kriteri 2. Përmbajtja e programit të studimit është aktuale, i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe kërkesat për aftësitë shprehite e kërkuara/të pritshme nga punëdhënësit.</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional në Kontabilitet është një program relativisht i ri i hartuar bazuar mbi aktualitetin ekonomik dhe social të vendit dhe si i tillë është orientuar drejt plotësimit të nevojave të veçanta të tregut të punës për ekspertë teknikë të nivelit hyrës në profesionin e kontabilistit, për të mundësuar një ekuilibrim të kërkesës dhe ofertës për këtë nivel pune që deri më sot plotësohet nga persona të mbikualifikuar gjë që sjell problematika siç është edhe mobiliteti i shpeshtë i punonjësve të kësaj kategorie.⁴⁷</p>
<p>Kriteri 3. Përmbajtja parashikon zhvillimin e aftësive të transferueshme, e shtrirë edhe në modulet e përmbajtjen e tyre, gjatë zhvillimit të kurikulës dhe në metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit.</p>	<p>Bazuar mbi mundësinë ligjore për transferimin e aftësive në nivele më të larta profesionale programi i studimit përfshinë në kurikulën⁴⁸ e tij lëndë të formimit bazë, të cilat do të shërbejnë në të ardhmen si themele mbi të cilat mund të ngrihen dije më të thelluara në fushën profesionale, apo teorike, të parashikuara në nivelet më të larta të studimit të ciklit të parë e më tej.</p>
<p>Kriteri 4. Modulet dhe aktivitetet e formimit teorik e praktik/punë konkrete mundësojnë përfitim e njohurive, aftësive dhe shkathtësive ndërkurrikulare, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve</p>	<p>Modulet dhe veprimtaritë e formimit teorik dhe praktik, të përfshira në kurikulën e programit të studimit me karakter profesional në Kontabilitet, janë bazuar në ndarjen sipas veprimtarive formuese A-E, ku studentët kanë mundësinë të</p>

⁴⁶ Dokumenti mbështetës nr. 7 – Rregullore e programit të studimit DP Kontabilitet

⁴⁷ Dokumenti mbështetës nr. 16 – Argumentimi për hapjen e programit

Dokument i mbështetës nr. 12.1, 12.2 – Bordet e Tregut të Punës 2018-2019 dhe 2019-2020

Dokument i mbështetës nr. 38 - Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimit profesional

⁴⁸ Dokumenti mbështetës nr. 14 – Kurikula e programit të studimit DP në Kontabilitet

në kontekste konkrete, komunikimin dhe marrëdhëniet me të tjerë, si dhe orientimin cilësor në përvojën e punës.	marrin përkrah njohurive karakterizuese të disiplinës edhe njohuri metodologjike, njohuri ndër-disiplinore, kulture të përgjithshme, njohuri plotësuese si dhe eksperiencë praktike. ⁴⁹			
Kriteri 5. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.	Bazuar në eksperiencën shumëvjeçare të stafit të departamentit në hartimin e kurikulave të orientuara drejt përmbushjes së nevojave dhe kërkesës së tregut për profesionistë të fushës së financës dhe kontabilitetit si dhe mbajtjes së kontakteve direkte të vazhduara me biznesin për të qënë kështu të azhurnuar me specifikat aktuale të tij, garanton formimin e studentëve të programit DP në Kontabilitet me dije dhe aftësi të aplikueshme në përputhje me kërkesat e profesionit. ⁵⁰			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional përmes politikave e udhëzimeve të posaçme dhe mbështetet në metodat dhe praktikat më të mira të fushës	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues të posaçëm, ngre struktura të posaçme dhe zhvillon mekanizma të vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar, duke përfshirë aktivisht studentët në këtë proces. Rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen publike.	Institucioni ka ngritur mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies janë: ⁵¹ <ul style="list-style-type: none"> vlerësimi i mësimdhënies në auditor, kryesisht për anëtarët e personelit akademik të kategorisë lektorë dhe asistentë lektorë, nga Dekani, Përgjegjësi i Departamentit ose përgjegjësit të grupit mësimor; vlerësimi i pedagogut dhe lëndës nga studentët që kryhet në fund të çdo semestri, duke ruajtur anonimatit e tyre, vlerësimi përmes fokus grupeve me studentët, si dhe përmes opinioneve e

⁴⁹ Dokumenti mbështetës nr. 14.2 – Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese

⁵⁰ Dokumentet mbështetëse nr. 20 – CV e stafit të angazhuar në programin e studimit; nr. 12.3 – Poster Panairi I punes 2018 dhe 12.2019; nr. 12.4 – Realitetet e reja post-covid ne tregun e punes 2020; nr. 12.5 – Bashkëpunime me biznesin 500+

⁵¹ Dokumenti mbështetës nr. 5 – Rregullorja e UET, neni 22

	<p>mendimeve që ata shprehin në mbledhjet e hapura të departamentit;⁵²</p> <ul style="list-style-type: none"> • vetvlerësimi;⁵³ • rezultatet e raporteve të KSBC-së; • vlerësimi nga Komisioni i Vlerësimit të Performancës që ngrihet nga Rektori (follow-up). • Zhvillimi i leksioneve të hapura, për një nga temat e planifikuara. <p>Rezultatet e vlerësimit pasi përpunohen nga KSBC, apo zyra e IT në rastin e vlerësimeve online i komunikohen autoriteteve drejtuese të UET, si edhe anëtarëve të personelit akademik nga Përgjegjësi i Departamentit. Departamenti analizon rezultatet, verifikon besueshmërinë e tyre, dhe merr masa për përmirësimet e nevojshme.</p>
<p>Kriteri 2. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra e kursit/eseja, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni e që është e përshtatshme për realizimin e programit të studimit.</p>	<p>Për të pasur një transmetim dhe përvetësim sa më të mirë të njohurive procesi mësimor zhvillohet me leksione, me seminare, leksion/seminare, me detyra praktike dhe me detyra kursi, praktikat profesionale, punim diplome ose provim të përgjithshëm përfundimtar.⁵⁴</p> <p>Kontrolli i dijeve është i vazhdueshëm, përgjatë gjithë semestrit, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të identifikojnë mangësitë dhe t'i plotësojnë ato përpara përfundimit të semestrit. Kontrolli i njohurive në secilën lëndë bëhet në përputhje me tipologjinë e lëndës⁵⁵. Gjithashtu, në bashkëpunim me tregun e punës, Departamenti ka zhvilluar leksione të hapura me ekspertë të fushës së financës.</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik përdor forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p>	<p>Mënyra e konceptimit dhe zhvillimit të mësimin në programin e studimit ndërtohet për të garantuar mundësinë e angazhimit të vazhdueshëm të studentëve. Zhvillimi i orëve interaktive, të cilat ndërthurin shpjegimet teoriko aplikative, duke u fokusuar te ndërveprimi i vazhdueshëm pedagog – student, garantojnë zhvillimin intensiv të procesit të angazhimit të studentëve. Diskutimet, rastet studimore, puna në grupe dhe prezantimet janë disa nga instrumentet kryesore që garantojnë ndërveprimin dhe angazhimin e studentëve. Institucioni gjithashtu prej disa vitesh tashmë ofron një sistem elektronik interaktiv të menaxhimit të procesit mësimor që është në përdorim të gjërë nga të gjithë studentët dhe pedagogët e UET-it.⁵⁶ Ky sistem garanton një kontakt të vazhdueshëm të studentit me pedagogun, rrit transparencën dhe informacionin, etj. Së fundmi si pasojë edhe e situatës pandemike, po eksperimentohet edhe mënyra interaktive e mësimdhënies online të cilën UET e ofron nëpërmjet platformës Microsoft Teams.⁵⁷</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në programin DP në Kontabilitet, është me eksperiencë të gjatë akademike siç edhe</p>

⁵² Dokumenti mbështetës nr. 40 - G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët

Dokument i mbështetës nr. 40.1 - D-VI-3-3 Formular për ankesat e studentëve

⁵³ Dokumenti mbështetës nr. 41 - G-I-12-1 Formular i vetvlerësimit të performancës së personelit akademik;

⁵⁴ Dokumenti mbështetës nr. 39 - A.III. Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës, pika A.III.3

⁵⁵ Dokumenti mbështetës nr. 0.2 – Tabela 15: Format e kontrollit të njohurive

⁵⁶ Dokumenti mbështetës nr. 46 – Manuali i përdoruesit të sistemit UMS; nr. 46.1 – Urdher për zbatimin e platformës LMS; nr. 46.2 – UET LMS Guide për pedagogun; nr. 46.3 – UET LMS Guide për studentet

⁵⁷ Dokumenti mbështetës nr. 5.1 - Vendim_Mbi zhvillimin e procesit akademik në situatën e krijuar nga pandemia

<p>e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, përfshirë ato interaktive e gjithëpërfshirëse, sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>dëshmohet nëpërmjet titujve dhe gradave që kanë, por gjithashtu edhe me një <i>background</i> të pasur profesional në këtë fushë, që mbështetet me kualifikime/certifikata kombëtare dhe ndërkombëtare.⁵⁸ Personeli akademik gjatë leksioneve/seminare përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, ku në varësi të tematikës përdor metodat tradicionale, ose bashkëkohore të mësimdhënies. Këto metoda ndërthuren duke pasur herë në qendër studentin dhe herë pedagogun.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të mbështesë stafin përmes njohjes me shembujt e praktikave të mira, të nxisë dhe të inkurajojë personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Analiza e rezultateve të përfituara nga procesi i vlerësimit periodik shërben jo vetëm për identifikimin e problemeve, por kanë si synim kryesor evidentimin e praktikave më të mira si dhe marrjen e masave për përmirësimin dhe garantimin e cilësisë. Në këtë kuadër UET organizon vazhdimisht trajnime të personelit akademik të fokusuar kryesisht në aspektet didaktike të mësimdhënies, duke nxitur përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të përshtatshme për fushën e studimit. Nga këto dallojmë eventin e organizuar në mënyrë periodike: “Staff Development Day” – Ditën e Zhvillimit të Stafit, me synimin trajnimin e stafit në fusha të lidhura me mësimdhënien, kërkimin, projektet dhe metodologjinë. Gjithashtu, në fillim të vitit akademik, Universiteti organizon edhe trajnimin dyditor: “Back to work”. Në realizimin e këtij kriteri vjen në ndihmë edhe inkurajimi dhe mbështetja e stafit akademik për pjesëmarrjen në veprimtari zhvilluese, si brenda ashtu dhe jashtë vendit. Këtu vlen të përmendet se, personeli akademik ka mundësi të përfitojë nga programet e shkëmbimit të stafit me universitetet partnere perëndimore, për të shkëmbyer eksperiencë dhe njohur me praktikën e mira ndërkombëtare, në fushën e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijes.⁵⁹</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.2 Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike të nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor teorik e praktik, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Infrastruktura në dispozicion të zhvillimit të procesit mësimor plotëson standardet dhe kriteret e cilësisë. Godinat janë të pajisura me sistem kondicionimi dhe sistem wireless. Sallat e leksionit janë organizuar në formë amfiteatri dhe me sistem fonie. Çdo sallë mësimore është e pajisur me PC dhe projektor. Laboratorët e informatikës janë të pajisura me programet e nevojshme të përcaktuara në programin</p>

⁵⁸ Dokumenti mbështetës nr. 20 - CV e stafit akademik të programit të studimit

⁵⁹ Dokumenti mbështetës nr. 43.2, 43.3 – Pjesëmarrja në projekte 2018-2019 dhe 2019-2020

	mësimor. Mjediset e UET janë gjithmonë të pastra, si rrjedhojë e punës shumë të mirë që bëhet nga stafi i punësuar për pastrimin dhe mirëmbajtjen e mjediseve të institucionit. ⁶⁰
Kriteri 2. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor, si dhe sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	Duke ndjekur zhvillimet e reja teknologjike UET ka investuar në sisteme, të cilat e mbështesin studentin në procesin mësimor. Më konkretisht në sistemin MOODLE (UET LMS), ky sistem bën të mundur që studenti në kohë reale të azhurnohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio vizive etj. ⁶¹
Kriteri 3. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	Biblioteka e UET është e pasur dhe disponon literaturën e mjaftueshme që ndihmon studentin në përvetësimin e dijeve sipas programit dhe lëndëve mësimore përkatëse. Biblioteka e UET furnizohet vazhdimisht me botime periodike. Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programeve. UET bën përpjekje të konsiderueshme për furnizimin me botime periodike dhe elektronike për t'i shërbyer pedagogëve dhe studentëve. ⁶² Biblioteka është abonuar për një periudhë 5-vjeçare në libraritë elektronike Sage & Ebsco si edhe Questia.
Kriteri 4. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Biblioteka mundëson aksesin në libraritë online si për personelin akademik, ashtu edhe për studentët. Stafi i bibliotekës ofron mbështetje gjetjen e burimeve on-line të kërkuara. Biblioteka është e pajisur me PC, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të lexojnë bibliotekat on-line të vëna në dispozicion nga UET. Gjithashtu biblioteka ka siguruar akses në burime ndërkombëtare elektronike për artikuj dhe libra shkencorë si: Questia, Social Science Library, Sage. ⁶³ Biblioteka e UET është pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online).
Kriteri 5. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	UET disponon infrastrukturën e nevojshme për realizimin e objektivave mësimore. Çdo sallë është e pajisur me PC dhe projektor të cilat shfrytëzohen nga studentët për realizimin e diplomave apo detyrave të kursit. Laboratorët e informatikës janë të pajisura me programet e nevojshme të përcaktuara në programin mësimor. Studenti mund të punojë në Bibliotekë ose në sallën e internetit për detyrat e kursit apo punimin e diplomës që duhet të shkruajë.
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line	Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik i UET përdor platformën online UET LMS. Sipas Urdhrit

⁶⁰ Dokumenti mbështetës nr. 42 - Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programit

⁶¹ Dokumenti mbështetës nr. 46 – Manuali i përdoruesit të sistemit UMS; nr. 46.1 – Urdher për zbatimin e platformës LMS; nr. 46.2 – UET LMS Guide për pedagogun; nr. 46.3 – UET LMS Guide për studentet

⁶² Dokumenti mbështetës nr. 45 - Inventari i teksteve Ekonomik

Dokument i mbështetës nr. 45.1 - Dokumenti E-IV. Mbi funksionimin e Bibliotekës

Dokument i mbështetës nr. 45.2 - E-IV-2 Formular për pasurimin e literatures në bibliotekë

⁶³ Dokumenti mbështetës nr. 0.2 – Tabela 17: Platformat online/ Biblioteka

(elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	administrativ për LMS, nr.09, date 02/11/2017 Mbi zbatimin e plote ne procesim mesimor administrativ te platformes UET LMS, personeli akademik, ne kuadër të digjitalizimit të procesit të mësimdhënies në UET dhe menaxhimin efektiv të tij, urdhërohet vendosja në efencë të plotë e platformës UET LMS me të gjitha funksionet e saj. Çdo pedagog në UET komunikon me studentët e tij nëpërmjet UET LMS. Nëpërmjet këtij sistemi pedagogu bën njoftime, ngarkon silabusin, prezantimet, leksionet, weblink-e me material shtesë, hedh pikët e çdo vlerësimi për studentët e tij, etj. ⁶⁴			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat garantojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit dhe rritjen e vetëdijes për përmirësimin e tyre	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që ndjekin, vlerësojnë dhe monitorojnë procesin e mësimdhënies dhe koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së saj.	<p>Në UET është ngritur dhe funksionon Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC)⁶⁵, i cili ngrihet në nivel institucional. Anëtarët⁶⁶ e saj propozohen nga Rektori dhe miratohen nga Senati i Universitetit.</p> <p>Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është një strukturë autonome, e përhershme në strukturën organizative të universitetit. Ai vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, si dhe propozon ndryshime për përmirësime të nevojshme, mbështetur në udhëzimet e sigurimit të cilësisë në hapësirën europiane të arsimit të lartë dhe legjislacionit në fuqi⁶⁷. Kjo zyrë bashkëpunon me njësitë kryesore dhe bazë dhe realizon një sërë aktivitetesh të parashikuara në planin e saj të veprimit⁶⁸, në funksion të monitorimit dhe përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Qëllimet e kësaj njësie në funksion të koordinimit dhe bashkërendimit me njësitë kryesore bazë në kuadër të</p>

⁶⁴ Dokumenti mbështetës nr. 46 - Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS
Dokumenti mbështetës nr. 46.1 - Urdher Mbi zbatimin e platformes LMS
Dokumenti mbështetës nr. 46.2 - UET LMS - Guide per pedagogun
Dokumenti mbështetës nr. 46.3 - UET_LMS_Guide per studentet

⁶⁵ Dokumenti mbështetës nr. 8 - Dokumenti F.VII Mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë

⁶⁶ Dokumenti mbështetës nr. 30 - Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC
Dokumenti mbështetës nr. 30.4 - Urdhër administrativ mbi përbërjen e KSBC

⁶⁷ Dokumenti mbështetës nr. 2 - Statuti i UET

⁶⁸ Dokumenti mbështetës nr. 30.1 - Plani i veprimit KSBC

	<p>përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie sipas pikës F.VII.3, në rregulloren e KSBC përfshijnë: Rritja e vazhdueshme e cilësisë së drejtimit të UET-it, nëpërmjet krijimit dhe zbatimit të politikave, strategjive dhe procedurave bashkëkohore, si edhe angazhimit të të gjitha niveleve drejtuese dhe organizative; aplikimi i vazhdueshëm i filozofisë së UET-it, duke zbatuar një program akademik që përkon si nga ana konceptuale dhe kronologjike me synimet që ka UET-i; rritja e vazhdueshme e cilësisë së formimit të studentëve, duke u ofruar atyre dijet, metodat dhe teknikat më bashkëkohore të mësimdhënies dhe duke nxitur përfshirjen e tyre në vendimarrje⁶⁹.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për procesin e mësimdhënies, cilësinë e saj dhe rritjen e vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Departamenti është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies në programet e studimit që ai ofron. Ai përzgjedh personelin akademik që angazhohet në mësimdhënie, si edhe garanton shpërndarjen e ngarkesës mësimore në përputhje me parimet dhe kriteret e vendosura për të garantuar që mësimi të zhvillohet nga personeli me ekspertizën dhe kualifikimin e nevojshëm. Gjithashtu, përgjegjësi i departamentit miraton silabuset e hartuara, bën vlerësimin e mësimdhënies, qoftë duke ndjekur zhvillimin e orëve të mësimi nga personeli akademik, qoftë duke inkurajuar studentët të raportojnë për problemet që mund të jenë evidentuar, në mbledhjet e hapura me ta, por jo vetëm. Stafi dhe studentët e dinë që do i nënshtrohen një procesi të vlerësimit të mësimdhënies, gjë e cila rrit vetdijen për cilësinë e mësimdhënies.⁷⁰</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, në përputhje me natyrën dhe specifikën e programeve profesionale.</p>	<p>Sigurisht që përdorimi i metodave të reja në mësimdhënie mbetet përgjegjësi individuale e personelit akademik. Pavarësisht përpjekjeve të institucionit për të promovuar përdorimin e këtyre metodave, përsëri vihet re se përvetësimi dhe shfrytëzimi i tyre në mësimdhënie përqafohet më lehtë nga brezi i pedagogëve të rinj, ndërkohë që përdoren më pak nga brezi i atyre me më shumë përvojë.</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies përmes trajnimeve të vazhdueshme të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të tyre.</p>	<p>Personelit akademik i kërkohet të shfrytëzojë maksimalisht metodat e reja inovative në procesin e mësimdhënies. Në formatin që përdoret për hartimin e silabuseve, personelit akademik i kërkohet të evidentojnë në një seksion të veçantë listën e materialeve audio-vizuale që do të përdoren në mësimdhënie.⁷¹</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Personeli akademik ka lirinë të testojë metoda të reja në mësimdhënie, dhe duke qenë se silabuset e lëndëve rishikohen çdo vit, ka mundësi të reflektojë përshtatjet dhe ndryshimet e nevojshme, në përputhje me rezultatet e përdorimit të tyre në përmirësimin e mësimdhënies dhe mësimdhënies tek studentët. Nëse gjatë punës së tyre ata vënë re se një eksperiencë e re është efektive, raportojnë për rezultatet në mbledhjen e departamentit, me synim që kjo eksperiencë pozitive të përhapet dhe shfrytëzohet edhe nga</p>

⁶⁹ Dokumenti mbështetës nr. 8 - Mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë

⁷⁰ Dokumenti mbështetës nr. 6 - Dokumenti F.IV-F. V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit

⁷¹ Dokumenti mbështetës nr. 19.1 - Formatit për hartimin e silabusit

	kolegët e tjerë. Por dhe në trajnimet e ndryshme të personelit akademik, stafi është i lirë të sugjerojë metoda që kanë rezultuar pozitive dhe të diskutojnë rreth tyre, me qëllim përhapjen e praktikave më të mira.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme për vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën për çdo student.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, të cilat bëhen publike. Institucioni mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimimet dhe rishqyrtimet e vlerësimit, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse.	<p>Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregulloren e programit të studimit, pika 5 “Kontrolli dhe vlerësimi i dijeve”, si edhe me dokument të veçantë rregullator të EUT.⁷²</p> <p>Për lëndët e Tipologjisë I, studentët zhvillojnë dy detyra praktike gjatë semestrit secila me 30% të notes përfundimtare dhe 40% të saj studentët e fitojnë përmes provimit final të sezonit. Për lëndët e Tipologjisë II, vlerësimi për notën përfundimtare mbështetet në këto komponentë: 10%, aktivizimi gjatë procesit mësimor, 20%, detyra e kursit, 30%, provim i ndërmjetëm dhe 40%, provimi final i sezonit. Edhe në kushtet e mësimdhënies online për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19, vlerësimi dhe kontrolli i dijeve mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, sipas kriterëve të përcaktuar në rregulloren e organizmit të mësimdhënies.⁷³</p> <p>Kriteret dhe mënyra e testimit të njohurive u njoftohen studentëve gjatë javës së orientimit (për studentët e rinj), por edhe nga secili pedagog në auditor për lëndët përkatëse. Gjithashtu, studenti mund të përfitojë nga shërbimi i kujdesit dhe këshillimit të vazhdueshëm, që ofrohet nga Koordinatorja e departamentit dhe Zyra e Kujdesit ndaj Studentit.</p>
Kriteri 2. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet	Vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe ka qëllim të trefishtë. a. Nxiti studentin që të mësojë gjatë

⁷² Dokumenti mbështetës nr. 7 – Rregullore mësimore e programit

⁷³ Dokumenti mbështetës nr. 5.1 – Vendim mbi zhvillimin e procesit akademik ne situaten e krijuar nga pandemia Covid-19

Dokumenti mbështetës nr. 5.2 – Rregullore tranzitore mbi vijimin e procesit akademik gjatë semestrit të parë te vitit akademik 2020-2021 në kushtet e pandemisë Covid-19

Dokumenti mbështetës nr. 5.3 – Rregullore tranzitore per zhvillimin e procesit akademik gjate vitit akademik 2020-2021

Dokumenti mbështetës nr. 0.2 – ANEKS: Tabelat permbledhese – Tabela 15: Kontrolli I njohurive

<p>në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>gjithë vitit; b. Prodhon një vlerësim më objektiv të studentit, duke e ndarë notën në disa komponentë në krahasim me vlerësimin e bazuar vetëm në një provim; c. Shërben për të vlerësuar ecurinë e kursit gjatë semestrit, nëse studentët janë duke e kuptuar materialin që po ofrohet në kurs. Në rregullore parashikohen forma të ndryshme të kontrollit të dijeve dhe aftësive, me qëllim që pedagogu të mund të zgjedhë atë që i përshtatet më mirë natyrës së lëndës dhe evidenton më mirë rezultatet e synuara të të nxënit.⁷⁴</p>
<p>Kriteri 3. Në fillim të çdo lënde/moduli, studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës /modulit.</p>	<p>Në fillim të çdo semestri studentët njihen me silabusin e lëndës, në të cilin përcaktohen në mënyrë të detajuar mënyra e kontrollit dhe format e vlerësimit të dijeve, së bashku me afatet kur duhet të plotësohet secili detyrim deri në përfundim të zhvillimit të lëndës. Njoftime të detajuara për detyrat dhe provimet në kuadër të lëndës vendosen edhe në platformën LMS, si dhe u njoftohen me email nga koordinatorja e departamentit.</p>
<p>Kriteri 4. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik, duke venë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat garantojnë anonimat, eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm gjatë gjithë semestrit. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementeve të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. Provimit të ndërmjetëm b. Nivelit të diskutimit në seminare c. Detyrës së kursit (ese, prezantime, projekte)/dy detyra praktike d. Provimit përfundimtar⁷⁵ <p>Për të rritur transparencën dhe për të eliminuar subjektivizmin dhe format e ndryshme të abuzimit në vlerësim, institucioni në bashkëpunim me AADF (Albanian-American Development Foundation) po promovon një sistem të ri vlerësimi elektronik: “clean scoring”.</p> <p>Si rregullm provimet zhvillohen me procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korrigjuara në Sekretarinë Mësimore. Sekretimi i tezave përmes sistemit elektronik të barkodeve, ofron sekretim të identitetit të studentit dhe paanshmëri të vlerësimit. Prej rreth 1 viti , për shkak të pandemisë, pjesa më e madhe e provimeve është zhvilluar online, provimet e ndërmjetme janë hequr, dhe realizimi i të gjitha rubrikave të vlerësimit të provimit , është bërë në formë elektronike.</p> <p>Provimet në formë elektronike zhvillohen në platformën UET LMS dhe në platformën Microsoft Teams, ku studentët dorëzojnë detyrat qoftë për punimet individuale, po ashtu për punimet e realizuara në grup, si dhe bëjnë provimet në kohë reale. Gjatë provimit, ata kontrollohen në kohë reale nga pedagogu i lëndës përgjatë seancës së provimit.</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisione provimi, shoqërohet me komente e këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të</p>	<p>Vlerësimi me komision është i detyrueshëm vetëm për detyrimet si praktika profesionale dhe punimi i diplomës/provimi i përgjithshëm përfundimtar. Në rastin e lëndëve të programit, është në gjykimin e titullarit nëse</p>

⁷⁴ Dokumenti mbështetës nr. 7.1 - Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve;

⁷⁵ Dokumenti mbështetës nr. 7 – Rregullore e programit të studimit, pika 5.2

<p>përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>korrigjimin do e bëjë i vetëm, apo në bashkëpunim me pedagogët asistentë. Në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit (provim i ndërmjetëm, detyrë kursi, provim përfundimtar), pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës, ai mund t'i drejtojë Përgjegjësit të Departamentit një kërkesë me shkrim, ku të parashtrijë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. Me marrjen e ankesës, Përgjegjësi i Departamentit ngre një komision me 3 anëtarë, i cili bën shqyrtimin e kërkesës dhe merr vendim me shumicë të thjeshtë⁷⁶</p> <p>Vlerësimi i performancës së studentit bëhet në të gjithë komponentët e parashikuar të detyrimit akademike që studenti duhet të përmbushë dhe kërkohet të shoqërohet me argumentet përkatëse nga ana e pedagogut, me qëllim që studenti të jetë i qartë mbi mangësitë apo gabimet në përgjigjet që ka dhënë, për të pasur mundësi t'i përmirësojë në testimet e radhës. Në funksion të sqarimit të studentit janë edhe seancat sqaruese, ku ata mund të shohin në detaje korrigjimin e pedagogut dhe të marrin drejtpërdrejtë nga ai/ajo komente të detajuara mbi vlerësimin e tyre.</p>			
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse, duke garantuar njëkohësisht të drejtat e studentëve, për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me këto rregullore.</p>	<p>Dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet brenda 2 (dy) javëve nga data e zhvillimit të tyre, brenda të cilave përfshihen edhe seancat sqaruese. Në rastin e riprovimeve, duke qenë se numri i studentëve pjesëmarrës është më i ulët se në sezonet normale, afati për dorëzimin e korrigjimeve është 1 (një) javë.⁷⁷ Vlerësimi për komponentët e tjerë duhet të dorëzohen përpara zhvillimit të provimit përfundimtar, dhe pedagogu nuk ka të drejtë të ndërhyjë për ndryshimin e tyre pas zbardhjes së rezultateve të provimeve.</p> <p>Studenti informohet në kohë reale për rezultatet e vlerësimit, përmes sistemit online. Ai informohet nga kordinatorja e departamentit për orarin që pedagogu ka vendosur për zhvillimin e seancës sqaruese. Gjatë kësaj seance, pedagogu i jep mundësi çdo studentit të rishikojë tezën dhe e informon në lidhje me përgjigjet e pyetjeve dhe elementët ku ai ka gabuar.</p> <p>Pas seancave sqaruese, nëse studenti mbetet i bindur se vlerësimi nga ana e pedagogut nuk është korrekt, atëherë mund t'i drejtohet Departamentit me kërkesë për rivlerësim. Vlerësimi i Komisionit që ngrihet është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi i kontestuar.⁷⁸</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.5
Zhvillimi i programit të studimit, deri në diplomim, garanton rritjen e aftësive krijuese e

⁷⁶ Dokumenti mbështetës nr. 7 – Rregullore e programit të studimit, pika 5.8

⁷⁷ Dokumenti mbështetës nr.5 - Rregllore e UET, neni 27

⁷⁸ Dokumenti mbështetës nr. 7 - Rregullorja e programit të studimit, pika 5.8

zbatuese tek studentët duke dhënë njëkohësisht njohuri të aplikuara dhe kompetenca profesionale lehtësisht të përdorshme në tregun e punës, apo për studime të mëtejshme.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë përfitim e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve, që janë në përputhje me rezultatet e pritura të të nxënit për programet me karakter profesional.</p>	<p>Ky program u ideua dhe u modelua me synim rritjen e mundësive për zhvillim dhe punësim të studentëve, të niveleve mesatare të formimit, në drejtim të njohurive profesionale cilësore, në përputhje me nevojat e tregut në vend për shërbimet e kontabilitetit. Rrjedhimisht, ky program studimi që në fillesat e tij, u mbështet në trajtimin e vëmendshëm të kompetencave që kërkon tregu shqiptar i punës dhe strukturës profesionale të vendeve të punës, kryesisht në institucionet private, por dhe ato publike, si dhe vet biznesin shqiptar. Për nga veçantia e shërbimeve të kontabilitetit, ndërtimi i kurrikulës së këtij programi studimi ka marrë në konsideratë kërkesat dhe veçoritë e tregut të punës në vend, si ato të sektorit privat dhe ato të sektorit publik, lidhur me nivelin dhe llojin e njohurive që një specialist, apo profesionist i këtij niveli të fushës së kontabilitetit duhet të zotërojë, me synim specializimin në këtë sektor shërbimesh. Programi i studimit është modeluar në mënyrë të tillë, që kombinon dijet bazë teorike mbi kontabilitetin, bazën ekonomike dhe financiare, me dije dhe aftësi praktike, lidhur me profesionin e kontabilistit dhe financierit.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton njohuritë e përshtatshme dhe zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, duke mbështetur diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave apo çështjeve të caktuara.</p>	<p>Siç u përmend edhe më lart, kurikula është e ndërtuar sipas kriterëve të veprimtarive formuese A-E të përcaktuara në VKM nr. 41, datë 24.1.2018 që ofron një harmonizim të lëndëve karakterizuese me ato plotësuese. Në këtë prizëm programi profesional në Kontabilitet garanton njohuri të përshtatshme për zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, atë humane e sociale, komunikimit, etj. (lëndët e Bazave të Informatikës, Sistemet e kompjuterizuara në Kontabilitet, Hyrje në Sociologji, Shkrim akademik, etj.)⁷⁹. Gjithashtu bazuar edhe mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës trajtimi i saj në auditor bazohet mbi metodologji pedagogjike që kanë në bazë komunikimin dhe ndërveprimin me studentët.⁸⁰</p>
<p>Kriteri 3. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale, duke garantuar realizimin në praktikë të marrëveshjeve me punëdhënësit e aktorët e biznesit në përfitim të formimit praktik të studentëve. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar</p>	<p>Në procesin e mësimdhënies në programin profesional DP në Kontabilitet ndërthuren njohuritë teorike me aplikimin e tyre praktik përmes orëve praktike, si dhe leksioneve të hapura ku përfaqësues të biznesit ndajnë eksperiencat praktike të punës së tyre të përditshme në industri dhe sektorë të ndryshëm të ekonomisë.</p> <p>Gjithashtu në kurikulën e programit është përfshirë lënda e Praktikës dhe Zhvillimit⁸¹ të karrierës e cila i jep studentit</p>

⁷⁹ Dokumenti mbështetës nr. 14 - Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese

⁸⁰ Dokumenti mbështetës nr. 39 - Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës

⁸¹ Dokumenti mbështetës nr. 19 – Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite

formimin cilësor dhe për të nxitur mobilitetin e studentëve.	mundësi të përshtatet sa më shpejt me tregun e punës si dhe shërben si mundësi e mirë për të krijuar kontakte që mund ti ndihmojnë për një punësim të mundshëm.
Kriteri 4. Në përfundim të çdo moduli apo lënde, personeli akademik vlerëson, analizon e shqyrton kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, duke nxjerrë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për implementimin e tyre.	Si rregull, pedagogët përpara përfundimit të lëndës bëjnë një përmbledhje të koncepteve dhe çështjeve kryesore të zhvilluara, duke përfshirë në diskutim edhe studentët dhe duke marrë mendimin e tyre për çfarë mund të përmirësohet në vijim. Eseja, apo detyra e kursit që zhvillohet përpara përfundimit të lëndës është një formë e shqyrtimit të aftësisë së studentëve, për të kuptuar çfarë ata kanë përfituar nga lënda. Në orën e fundit të mësimit, pedagogu përveçse ndalet edhe njëherë në çështjet më të rëndësishme të trajtuara gjatë semestrit, jep edhe orientimet e nevojshme se ku duhet të fokusohen studentët për përgatitjen e tyre në provim. Pedagogu mund të ndalet më gjatë në elementët që kanë rezultuar më të vështirë për t'u përvetësuar nga studentët, gjatë semestrit. Gjithashtu, pedagogu është në dispozicion të studentëve për konsulta përpara provimit edhe gjatë orëve të takimit zyrtar, sipas grafikut të shpallur në fillim të semestrit.
Kriteri 5. Institucioni harton procedura të posaçme, të njohura e publike për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Ai mban regjistra zyrtarë të studentëve të diplomuar dhe i përditëson ata në fund të çdo viti akademik.	Dokumenti B.II Për punimin e diplomës ⁸² , jep në mënyrë të detajuar çdo procedurë që ndiqet nga aplikimi dhe miratimi i temës së diplomës, deri tek procesi i udhëheqjes së saj përmes seancave metodologjike, deri tek formati i dorëzimit dhe mbrojtja përpara komisionit. Ky informacion i vihet në dispozicion studentit përpara aplikimit për punim diplome. Studentët e programit në përfundim të studimeve të tyre realizojnë një punim diplome në formën e rastit studimor, rast krahasues ose projektit kërkimor (për studentët me mesatare në hyrje mbi 7.5, ose i nënshtrohen një provimi përfundimtar, në formën e rastit studimor kompleks, të lidhur me profilin përkatës të studimit. Departamenti kujdeset që studentët të pajisen me gjithë dokumentacionin udhëzues në lidhje me përbushjen e këtij detyrimi konform përcaktimeve në rregullore. Për studentët që përgatisin punim diplome, pedagogu udhëheqës i udhëzon për strukturën e projektit, metodologjinë, i orienton studentët drejt literaturës që ata duhet të lexojnë në funksion të projektit, u jep udhëzime dhe të gjitha materialet e nevojshme për përfundimin me sukses të projektit. Studentët që i nënshtrohen provimit të përgjithshëm orientohen në lidhje me literaturën që duhet të shfletojnë, si edhe u zhvillohen në klasë raste studimore të ngjashme, me qëllim që të familjarizohen me këtë formë testimi. ⁸³
Kriteri 6. Njësia përgjegjëse, personeli akademik dhe udhëheqësit akademikë orientojnë dhe ndihmojnë studentët për përgatitjen e punimit të diplomës, realizimin e veprimtarisë praktike dhe përpunimit të rezultateve, duke garantuar bashkëpunimin	Diplomimi bëhet me përgatitjen dhe mbrojtjen e një projekti profesional me karakter aplikativ/praktik për një temë të caktuar praktike aplikative ose nëpërmjet Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar (PPP) që zhvillohet në formën e rastit studimor, të lidhur ngushtë me lëndët karakterizuese të programit (Kategoria B). ⁸⁴ Në të dyja rastet përgatitjen e

⁸² Dokumenti mbështetës nr. 10 - Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit;

⁸³ Dokumenti mbështetës nr. 7 – Rregullore e programit të studimit DP në Kontabilitet, Pika 8.

⁸⁴ Dokumenti mbështetës nr. 7 – Rregullore e programit të studimit DP në Kontabilitet, Pika 8; Dokumenti mbështetës nr. 10 - Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit, Pika B.II.5, Pika B.II.6.3

edhe me aktorë të jashtëm për realizimin e saj.	studentëve për mbrojtjen finale, pedagogët udhëheqës zhvillojnë seancat metodologjike, sipas një kalendari takimesh, të shpallur.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për përzgjedhjen dhe cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive nga ana e tyre	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton procedura dhe kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të tij.	Rekrutimi i personelit akademik bëhet në përputhje me nevojat për personel akademik, bazuar në planet mësimore që zhvillohen në kuadrin e çdo Fakulteti/Departamenti, si dhe ngarkesat mësimore të miratuara. Synimi kryesor është zhvillimi i ngarkesës mësimore kryesisht me personel të brendshëm e të qëndrueshëm. Procedura e përzgjedhjes së stafit është e përcaktuar në Rregulloren e Burimeve Njerëzore dhe përcakton në mënyrë të detajuar kriteret dhe mënyrën e rekrutimit në përputhje me bazën ligjore në fuqi. ⁸⁵ Universiteti harton dhe publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik. Kriteret shpallen publikisht dhe përzgjedhja bëhet me konkurs. Për çdo vend vakant njoftimet bëhen në faqjen zyrtare të universitetit ⁸⁶ , rrjetet sociale ⁸⁷ dhe në gazetën Liberale.

⁸⁵ Dokumenti mbështetës nr. 11 - Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore

⁸⁶ Faqja zyrtare e Universitetit Europian të Tiranës www.uet.edu.al

⁸⁷ Dokumenti mbështetës nr. 11.1 - Shembull thirrje për staf akademik

<p>Kriteri 2. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program, personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, përfshirë tutorët apo vëzhguesit e praktikës në institucionet partnere, si dhe atë të personelit ndihmësmësor-shkencor dhe administrativ të angazhuar.</p>	<p>Të dhënat e personelit mblidhen, ruhen dhe përditësohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore⁸⁸, e cila krijon Dosjen Individuale të Stafit Akademik, me kohë të plotë dhe të pjesshme, në të cilat depozitohet i gjithë dokumentacioni⁸⁹. Zyra e Burimeve Njerëzore mban evidencë edhe për realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik për secilin semestër</p> <p>Personeli i angazhuar në programin e studimit me karakter profesional “Kontabilitet” realizon ngarkesën⁹⁰ mësimore sipas akteve në fuqi dhe kontratës së lidhur me UET. Stafit akademik i angazhuar në program në vitin akademik 2020-2021, ka kualifikimin si vijon: 2 pedagoge me titull “Profesor Doktor”, 3 pedagogë me titull “Profesor i Asociuar”, 2 pedagogë me gradën shkencore “Doktor”, 2 doktorant dhe 13 pedagogë me titull “Master i Shkencave”, prej të cilëve vetëm një angazhohet me kohë të pjesshme. Departamenti ka si qëllim të realizojë një cilësi të lartë të mësimdhënies nëpërmjet eksperiencës së pedagogëve dhe mjeteve inovative të mësimdhënies.⁹¹</p> <p>Stafit akademik i programit për vitin akademik 2020-2021 përbëhet nga pedagogë efektivë në masën mbi 90%.⁹²</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit me karakter profesional dhe për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Mbështetja institucionale për kërkimin shkencor, trajnimet e vazhdueshme dhe parimi i shpërndarjes së lëndëve në bazë të ekspertizës janë disa nga treguesit kryesor të angazhimit optimal të burimeve njerëzore në funksion të përmbushjes së objektivave të programit të studimit.⁹³</p> <p>Institucioni është i angazhuar në krijimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mjedisit të përshtatshëm për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. Kapacitetet infrastrukturore në dispozicion, salla e departamenteve, zyrat dyshe, zyrat individuale të drejtuesve, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme (poste pune, kompjuter, sistem kondicionimi dhe ndriçimi) janë tregues të një mjedisi të përshtatshëm⁹⁴.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit, përmes organizimit të</p>	<p>Zhvillimi profesional i stafit është një ndër objektivat strategjik të institucionit, i cili garantohet si nga zhvillimi i aktiviteteve nga vetë institucioni ashtu edhe nga mbështetja institucionale për stafin për të ndjekur trajnime dhe aktivitetet të tjera zhvillimore në institucione të tjera, brenda dhe jashtë vendit⁹⁵. Zhvillimi i</p>

⁸⁸ Dokumenti mbështetës nr. 11 - Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore

⁸⁹ Dokumenti mbështetës nr. 44 - Format Dosje Stafit Akademik

⁹⁰ Dokumenti mbështetës nr. 25 - Ngarkesa mesimore ne auditor e stafit akademik te programit

⁹¹ Dokumenti mbështetës nr. 25 - Ngarkesa mesimore ne auditor e stafit akademik te programit

Dokumentit mbështetës nr. 0.2 - ANEKS: Tabelat permbledhese – Tabelat 12

Dokumentit mbështetës nr. 20 - CV e stafit akademik

⁹² Dokumenti mbështetës nr. 0.2 - ANEKS: Tabelat permbledhese – Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin e studimit ndër vite” Aneks tabela 6

⁹³ Dokumenti mbështetës nr. 43 dhe 43.1 – Te dhena mbi kerkimin shkencor 2018-2019 dhe 2019-2020

⁹⁴ Dokumenti mbështetës nr. 42 – Infrastruktura në funksion të programeve të studimit

⁹⁵ Dokumenti mbështetës nr. 2 – Statuti UET, neni 6, pika 6.3; Dokumenti mbështetës nr. 33 – Trajnime profesionale; Dokumenti mbështetës nr. 43.1 - Trajnim mbi sistemin UET LMS; Dokumenti mbështetës 43.2

<p>programeve specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, si dhe mbështetjen për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>konferencës shkencore “Ditët e Studimeve Shqiptare” sikurse dhe botimi i revistave shkencore (Revista ECONOMICUS e specializuar në fushën e shkencave ekonomike) janë disa nga treguesit e rëndësishëm që institucioni i kushton zhvillimit të vazhdueshëm të stafit. Përfshirja në një numër të konsiderueshëm projektesh, të financuara nga donatorë të ndryshëm, dhe me partnerë nga vendet e BE-së dhe rajoni, është një tjetër tregues i strategjisë së institucionit në kuadër të zhvillimit të vazhdueshëm të stafit⁹⁶. UET ka ndërtuar skemën e financimit të kërkimit shkencor, duke krijuar një fond prej 75.000 Euro për stafin që boton artikuj në revista shkencore të indeksuara në Thomson Reuters/Scopus. Nisma më e fundit e UET është krijimi i një Grupi Kërkimi Ndërdisciplinor (IRG) prej 10 profesorësh të disiplinave të ndryshme, të cilëve iu është akorduar një fond vjetor për kërkim shkencor, prej 5.000 euro/secili.</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të përshtatshëm sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit me karakter profesional</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Mjediset e ofruara nga institucioni janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë akademike⁹⁷. Institucioni ka në dispozicion salla të kapaciteteve të ndryshme duke akomoduar studentë sipas llojit të veprimtarisë dhe në përputhje me normativat në fuqi. Sipërfaqet e shfrytëzueshme janë të ndara në salla leksionesh, gjithsej 10 salla me sipërfaqe totale 1.510m² dhe 1.515 vende. Salla seminari janë gjithsej 14, me sipërfaqe 45m² dhe secila me nga 35 karrige. Salla 70 vendëshe (leksione + seminare) janë gjithsej 9 salla me sipërfaqe 100m² secila.</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, studiot e mjediset e tjera janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>UET ka aktualisht në përdorim 4 laboratorë mësimorë informatike, dhe auditorë të pajisur me mjete audio vizive si: PC, projektore dhe foni, në rastin e sallave të leksionit. Laboratorët e informatikës/statistikës janë pajisur me software-t përkatës në mënyrë që t'i shërbejnë sa më mirë programit mësimor. Duke ndjekur zhvillimet e reja teknologjike UET ka investuar në sisteme të cilat e mbështesin personelin akademik dhe studentin në procesin mësimor. Më konkretisht në sistemin MOODLE (UET LMS), ky sistem bën të mundur që studenti në kohë reale</p>

dhe 43.3 – Pjesëmarrja ne projekte 2018-2019 dhe 2019-2020; Dokument mbeshtetes nr. 46.4 – Video-trajtime mbi sistemin TEAMS/LMS

⁹⁶ Dokumenti mbështetës nr. 43.4 – Projekte UET 2018-2020

⁹⁷ Dokumenti mbështetës nr. 42 - Infrastruktura në funksion të programeve të studimit

	të azhurnohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shitesë audio vizive etj. ⁹⁸			
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas fushës specifike të programit profesional, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Mësimi zhvillohet në salla leksioni të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si: PC, projektore, foni dhe internet. Nga vetë natyra e këtij programin nuk është e nevojshme zhvillimi i mësimin në laboratore, studio apo atelie. Në sallat e pajisura me mjete audio vizive u mundësohet studentëve paraqitja e materialeve të ndryshme dhe dokumentacioneve, të cilat do të hasin gjatë praktikës së punës, u demonstron si bëhen teste të ndryshme, etj.			
Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.	Institucioni, në godinën B, strehon laboratorët si më poshtë vijon për Fakultetin e Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron: <ul style="list-style-type: none"> - 4 Laboratorë Informatike, përkatësisht: - Lab 205 B me 25 PC dhe video projektor rreth 45 m2; - Lab 206 B me 35 PC dhe video projektor rreth 45 m2; - Lab 207 B me 35 PC dhe video projektor rreth 45 m2; - Lab 208 B me 80 PC (laboratori i internetit) – 160m2. 			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale, internship-it dhe veprimtarive të tjera praktike thelbësore për programet me karakter profesional.	Praktika profesionale është detyrim akademik që synon të lidhë njohuritë teorike dhe praktike të fituara gjatë studimeve me profesionin/et përkatës/e dhe t'i familjarizojë studentët me tregun e punës. UET garanton infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e veprimtarive praktike në institucion sikurse dhe bashkëpunon me institucione dhe organizata të tjera në funksion të kryerjes së praktikave profesionale të studentëve. ⁹⁹			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedisë mbështetëse e të posaçme të mësimnxënies, bibliotekën e literaturën dhe mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe realizimin cilësor të tij

⁹⁸ Dokumenti mbështetës nr. 46 - Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS
Dokumenti mbështetës nr. 46.1 - Urdher Mbi zbatimin e platformës LMS
Dokumenti mbështetës nr. 46.2 - UET LMS - Guide për pedagogun
Dokumenti mbështetës nr. 46.3 - UET_LMS_Guide për studentët

⁹⁹ Dokumenti mbështetës nr. 32 - Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit;
Dokumenti mbështetës nr. 34 Marrëveshjet e bashkëpunimit; Dokumenti mbështetës nr. 32 - Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikën profesionale; Dokumenti mbështetës nr. 32.1 - Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit dhe krijon kushte për akses të barabartë e pa pagesë dhe të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Biblioteka e institucionit, e vendosur në godinën C dhe me një sipërfaqe prej 300 m² është e aksesueshme nga të gjithë studentët në mënyrë të barabartë, përfshirë dhe studentët e programit DP në Kontabilitet.</p> <p>Biblioteka është e pajisur me PC/wi-fi, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të lexojnë bibliotekat on-line të vëna në dispozicion nga institucioni. Biblioteka e UET është pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online). COBISS.Net është një rrjet ku janë të përfshira të gjitha vendet e rajonit të Europës Juglindore, e cila përfaqëson një model organizativ të lidhjes së bibliotekave në sistemin kombëtar të informacionit bibliotekar me katalogim të përbashkët, me bazën bibliografike (katalogun) të përbashkët të të dhënave dhe me bazat lokale të bibliotekave pjesëmarrëse.</p> <p>Biblioteka funksionon me orar të gjatë dhe ofron kushte të mira dhe një fond të pasur botimesh hard copy dhe elektronike, në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaja, për të mbështetur studentët dhe personelin akademik në punën e tyre studimore dhe kërkimore shkencore. Të dhëna të detajuara gjenden në dokumentin nr. 42: Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë mësimore bazë, ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka ka një fond të konsiderueshëm të përbërë nga libra, periodikë, CD dhe harta), në gjuhë shqipe dhe gjuhë të huaj. Aksesit i literaturës së programit nga studentët, garantohej nëpërmjet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Literaturës fizike në bibliotekë, e cila pasurohet vit pas viti. Stafi akademik parashtron kërkesën për blerëjen e literaturës nëpërmjet plotësimit të formatit përkatës¹⁰⁰; 2. Aksesit në libraritë elektronike Sage, Ebsco dhe Questia; 3. Katalogut të librave elektronik e krijuar nga biblioteka, i cili ka në gjuhë të huaj qindra tituj; 4. Materialeve të vëna në dispozicion nga titullarët në sistemin UET LMS.
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit dhe duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Abonimi në bibliotekat elektronike Sage, Ebsco dhe Questia dhe kapacitete infrastrukturore në bibliotekë (PC, wi-fi) garantojnë përmbushjen e këtij kriteri. Aksesit i studentëve është pa pagesë. Pasurimi i fondit të bibliotekës është një proces i vazhdueshëm dhe objektiv i rëndësishëm i institucionit. Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programeve. UET bën përpjekje të konsiderueshme për furnizimin me botime periodike dhe elektronike për t'i shërbyer studentëve dhe pedagogëve.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, përmes bashkëpunimit me aktorë të jashtëm, të angazhuar në realizimin e programit mësimor, duhet t'u lehtësojnë dhe garantojë studentëve mbështetjen dhe përdorimin e burimeve e logjistikës së nevojshme të institucioneve partnere, në varësi të natyrës së angazhimit të tyre në procesin formues teorik, praktik dhe</p>	<p>Departamenti i Ekonomiksit & Financës ka një marrëveshje bashkëpunimi me Zyrën e kontabilitetit AKH, e cila u mundëson studentëve, për qëllime mësimore, akses të plotë në software-t profesionalë për mbajtjen e kontabilitetit dhe veprimet kontabël që përdoren nga kompanitë dhe bizneset shqiptare (Alfa, Financa V), e konkretisht në lëndën: Sisteme të Kompjuterizuara në Kontabilitet.¹⁰¹</p>

¹⁰⁰ Dokumenti mbështetës nr. 45.2 - E-IV-2 Formular për pasurimin e literatures ne biblioteke

¹⁰¹ Dokumenti mbështetës nr. 34.10 – Marreveshje bashkepunimi UET_AKH

profesional të studentëve.									
Kriteri 5. Institucioni parashikon koston financiare të programit të studimit profesional, mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi dhe raportin financiar të përvitshëm dhe në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi.	Buxheti financiar fillon të hartohet në muajin tetor të çdo viti. Për zbatim të këtij buxheti, ngarkohet Administratori dhe Zyra e Financës. Projekt- buxheti hartohet në mënyrë të tillë ku percaktohet çdo muaj një raport i drejtë i të ardhurave dhe shpenzimeve duke përcaktuar dhe rezervat e nevojshme për shpenzimet që kanë prioritet në vazhdimësi. Plani i financimit hartohet në nivel institucional, ku përfshihen të gjithë kostot dhe të ardhurat ¹⁰² . Për shkak të përmasave të institucionit por edhe faktit që infrastruktura por edhe stafi angazhohet në programe të ndryshme është praktikisht e pamundur të hartohen raporte në bazë të programeve të studimit. ¹⁰³								
Kriteri 6. Financimi i një programi studimi profesional duhet të sigurojë e të garantojë mbulimin e të gjitha burimeve dhe veprimtarive të qëndrueshme dhe operative, të lidhura e që janë në funksion të realizimit të programit të studimit, duke garantuar njëkohësisht qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit e në vijim.	Të dhënat financiare dëshmojnë aftësinë e institucionit për të garantuar qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit, sikurse dhe dëshmon kapacitete për gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen. ¹⁰⁴								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek, zbaton politika e procedura institucionale dhe i jep formacion të plotë e të hollësishëm studentëve mbi programin e studimit me karakter profesional, pranimin, përzgjedhjen, përparimin akademik, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton, zbaton dhe bën publike politika, procedura e kritere të qarta e të kuptueshme për pranimit e studentëve, përparimin e tyre përgjatë kursit të studimit, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët, në	Procesi nga pranimi deri në dalje mbështetet në: legjislaacionin në fuqi, statutin dhe rregulloret përkatëse ¹⁰⁵ , burimet njerëzore dhe kapacitetet infrastrukturore. Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit publikohet online ¹⁰⁶ , në broshurën informuese (Guida UET), fushatat informuese mediatike, si edhe gjatë këshillimit në institucion. Institucioni kujdeset që të ndjekë

¹⁰² Dokumenti mbështetës nr. 49 – Të dhëna mbi kostot për student; Dokumenti mbështetës nr. 50 - Të ardhura dhe financime të ndryshme;

¹⁰³ Dokumenti mbështetës nr. 0.2 – Aneks Tabelat mbështetese: Të dhëna mbi koston për student” Aneks Tabela 18.1; “Të ardhura dhe financime të ndryshme” Aneks Tabela 18.1

¹⁰⁴ Dokumenti mbështetës nr. 0.2 – Aneks Tabelat mbështetese: Të dhëna mbi koston për student” Aneks Tabela 18.1; “Të ardhura dhe financime të ndryshme” Aneks Tabela 18.1

¹⁰⁵ Dokumenti mbështetës nr. 27.1 - Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve

¹⁰⁶ <http://uet.edu.al/new/si-te-aplikojme/>

<p>përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>ecurinë e studentit gjatë gjithë procesit, duke hartuar dhe zbatuar politika dhe procedura.¹⁰⁷</p> <p>Politikat dhe procedurat mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore, të cilat gjenden të detajuara në dokumentet e institucionit. Përmes këtyre dokumenteve, studentët sqarohen për procesin e pranimit dhe kriteret që duhet të plotësohen për pranim në programet e studimit dy- vjeçare, strukturën e studimit, programin e lëndëve, kreditet e nevojshme për t'u diplomuar, mënyrën e vlerësimit, procesin e diplomimit dhe gjithçka tjetër që studentit mund t'i duhet gjatë studimeve të tij¹⁰⁸.</p> <p>Institucioni trajton të gjithë studentët në mënyrë të barabartë dhe demokratike gjatë gjithë ciklit të studimit, duke ruajtur dhe siguruar pritshmëritë e synuara për cilindo prej tyre, me qëllim që të përballojnë me sukses në të ardhmen terrenin dhe mundësitë dhe kërkesat që ofron tregu i punës.¹⁰⁹</p> <p>Studentët mund të gjejnë të gjithë informacionin rreth programit të studimit, kriterëve të pranimit, bursave që ofrohen tek faqja zyrtare web¹¹⁰. Gjithashtu informacioni i plotë rreth kriterëve, procedurave të pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë të kuptueshme dhe të aksesueshme nga vetë studentët¹¹¹.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të përgjithshme dhe/ose të veçanta për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit me karakter profesional dhe udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me to.</p>	<p>Me qëllim për të nxitur vendimarrjen e gjithë secilit në mënyrë të pavaruar si edhe për të plotësuar interesat dhe pritshmëritë profesionale të gjithëkujt, institucioni harton dhe publikon çdo vit akademik kriteret dhe vendet vakante për programin e studimit, duke informuar studentët potencial për natyrën praktike të degës. Të gjithë kriteret, si të përgjithshme edhe të veçanta, publikohen në faqen e UET, i bëhen të ditura të interesuarve gjatë kontakteve me ta, sikurse dhe pasqyrohen në dokumentet respektive të listuara në kriterin 1. Dokumentacioni i vihen në dispozicion palëve të interesuar nëpërmjet rrugëve dhe instrumenteve të ndryshme të komunikimit.¹¹²</p> <p>Përpara fillimit të çdo viti akademik në faqen e internetit të universitetit¹¹³, në faqen e facebook-ut, në njoftimet që bëhen në UET, në "Gjimnaz Tour-et", studentët njoftohen në kohë për</p>

¹⁰⁷ Dokumenti mbështetës nr. 28 - Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin;

Dokumenti mbështetës nr.12 - Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit;

Dokumenti mbështetës nr. 27.2 - Dokumenti A-V Mbi tutoriatin, këshillimin akademik dhe këshillimin metodologjik;

Dokumenti mbështetës nr. 7 - Rregullore mësimore DP Kontabilitet

¹⁰⁸ Dokumenti mbështetës nr. 7 - Rregullore e programit të studimit DP Kontabilitet

¹⁰⁹ Dokumenti mbështetës nr. 5 - Rregullore e UET

¹¹⁰ Faqja zyrtare e Universitetit Europian të Tiranës www.uet.edu.al

¹¹¹ Dokumenti mbështetës nr. 5 - Rregullore e UET", Kreu III, neni 11, Kreu IX, neni 38, Kreu VII, neni 35

¹¹² Dokumenti mbështetës nr. 51 - Komunikimi i integruar i marketingut; Dokumenti mbështetës nr. 48 - Dokumenti E.V. Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET online

¹¹³ Të dhëna nga Faqja zyrtare e Web (<https://uet.edu.al/new/si-te-aplikojme/?lang=sq>)

	<p>mënyrën e aplikimit dhe dokumentet e nevojshme. Programi i studimit pranon kandidatët në varësi të kapaciteteve infrastrukturore dhe akademike të UET-it dhe sipas kriterëve specifike që mund të përcaktohen paraprakisht nga Dekanati. Numri i maksimal i studentëve që mund të regjistrohen dhe mënyrat e përzgjedhjes së tyre, bëhen publike çdo fillim viti akademik, para fillimit të regjistrimeve. Në fillim të vitit akademik organizohet java orientuese, ku mbahen takime dhe leksione për shpjegimin e sistemit të studimeve, të rregulloreve dhe të procedurave administrative në UET për studentët e rinj.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, zhvillimin e veprimtarive praktike e profesionale të programit dhe institucionet bashkëpunuese në këto veprimtari, vlerësimin të dijeve e aftësive të studentëve dhe diplomimit.</p>	<p>I gjithë informacioni i plotë dhe i hollësishëm gjendet në rregulloren mësimore të programit të studimit¹¹⁴ dhe aktet e tjera rregullatore. Studentët njihen me rezultatet e tyre nëpërmjet platformave online UMS dhe LMS. Studentët e interesuar mund të tërheqin pranë koordinatores së Departamentit formularin e paradiplomimit, në të cilën gjenden të gjithë lëndët dhe rezultatet respektive, sikurse dhe statusi për çdo lëndë.</p> <p>Kriteret dhe procedurat e vlerësimit i bëhen të ditura studentëve dhe parashikohen në rregulloren mësimore të programit të studimit. Ato janë pjesë e silabuseve të lëndëve, të cilat i vihen në dispozicion dhe i shpjegohen studentëve që në fillim të procesit akademik¹¹⁵.</p>
<p>Kriteri 4. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve, mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Informacioni mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit i vihet në dispozicion studentëve nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Këshillimit me stafin akademik në momentin që interesohen për programet e studimit; • Kontakteve me Zyrën e Kujdesit ndaj Studentit; • Rregullores mësimore të programit të studimit <p>Institucioni i kushton një vëmendje të veçantë orientimit të studentëve drejt tregut të punës, nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, e cila e zhvillon aktivitetin e saj në bashkëpunim të ngushtë me këshilluesit e karrierës së çdo fakulteti/departamenti, si dhe duke u diferencuar në funksion të nivelit të studimit¹¹⁶; • Bordeve të tregut të punës – të cilat shërbejnë si urë lidhëse midis universitetit dhe tregut të punës¹¹⁷; • Organizimit të panairëve të punës dhe aktivitete me aktorë nga tregu i punës¹¹⁸; • Dërgimit të njoftimeve tek studentët mbi mundësitë e ndryshme për punësim.
<p>Kriteri 5. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese dhe informacion të gjerë e të përditësuar mbi zhvillimin dhe</p>	<p>Informacioni për programin dhe komponentët përbërës i vihen në dispozicion studentëve nëpërmjet mënyrave të listuara në kriterin 1 më lart, sikurse gjenden edhe në faqen online të institucionit. Silabuset e lëndëve shpërndahen përpara fillimit të çdo semestri dhe shpjegohen nga titullarët në orën e parë të leksionit për</p>

¹¹⁴ Dokumenti mbështetës nr. 7 - Rregullore mësimore DP Kontabilitet

¹¹⁵ Dokumenti mbështetës nr. 19 – Syllabuset e lëndëve të ofruara

¹¹⁶ Dokumenti mbështetës nr.12 - Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit

¹¹⁷ Dokumenti mbështetës nr.12.1 dhe 12.2 – Bordi I tregut të punës 2018-2019 dhe 2019-2020

¹¹⁸ Dokumenti mbështetës nr.12.3 – Poster Panairi i punës 2018dhe 2019; Dita e Biznesit në UET -

<http://uet.edu.al/new/dita-e-biznesit-ne-uet/> ; <http://uet.edu.al/new/edukimi-financiar-sa-te-informuar-jane-te-rinjte-sot/>

<p>organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>secilën lëndë. Që në momentin e interesimit e deri në përfundim të studimeve, studentëve i vihet në dispozicion informacioni i nevojshëm mbi proceset mësimore. Një nga detyrat e koordinatorës së departamentit është mbajtja e kontakteve të rregullta, njoftimeve elektronike dhe me telefon, me studentët që ndjekin programe studimi të Departamentit. Çdo ndryshim në orar, ose ndryshim gjatë zbatimit të tij, u njoftohet studentëve përmes njoftimeve të koordinatorëve të departamenteve dhe shpallet në këndin e njoftimeve. Çdo informacion tjetër në lidhje me procesin mësimor, kalendarin akademik dhe aktivitete të ndryshme mësimore që organizohen në UET, dërgohen përmes postës elektronike dhe sistemit LMS.</p>			
<p>Kriteri 6. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Programi i studimit, me lëndët përbërëse të tij, sipas viteve dhe semestrave është i publikuar në faqen e internetit të UET-it. Gjithashtu studentët në fillim të secilit semestër pajisen me të gjithë silabuset e lëndëve, ku jepen në detaje temat e lëndës, literatura kryesore, forma e kontrollit të dijeve, literatura e rekomanduar. Ky informacion është edhe pjesë e platformës LMS, ku çdo student sheh gjithë materialet e lëndës që pedagogët vendosin në portal, krahas silabusit.</p> <p>Të gjithë anëtarët e personelit akademik, efektiv dhe me kohë të pjesshme, të cilët zhvillojnë mësim u jepet akses vetëm tek lënda/lëndët e tyre, dhe tek grupet përkatëse me të cilët zhvillojnë mësim. Çdo pedagog mund të shohë lëndët e veta dhe të menaxhojë lehtësisht gjithë literaturën e lëndëve përkatëse; Sistemi ofron mundësi për çdo lloj kërkese që pedagogu mund të ketë për organizimin e procesit të mësimdhënies, si p.sh. caktimi detyrave të kursit, të gjitha llojet e vlerësimit për çdo tipologji, pyetësorë të ndryshëm, evente, forum diskutimi online mes studentëve dhe pedagogut, dhe shumë funksione të tjera. Të gjitha këto sigurojnë një informim të mirë të studentëve në lidhje me ecurinë e studimit dhe janë lehtësisht të aksesueshme në çdo moment nga studentët.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.5 Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni disponon një sistem informatik për menaxhimin e informacionit të studentit. Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Universitetit (UMIS) është një program informatik i cili është krijuar për të realizuar ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të studentit, atyre akademike, prodhimin e raporteve statistikore si dhe menaxhimin e aspekteve të funksionimit të Universitetit, si: financat studentore, aktivitetin e Bibliotekës, etj. Përmbajtja e informacioneve/njoftimeve që</p>

	<p>lidhen me UMIS administrohen nga personi pranë Zyrës IT-së me detyrë funksionale menaxhimin teknik të sistemit UMIS. Gjithashtu çdo student ka dosjen e tij, ku përmbahen të gjitha të dhënat; nga momenti i regjistrimit e deri pas diplomimit. Këto të dhëna gjenden në Sekretarinë Mësimore dhe në Zyrën e Regjistrimit të Studentëve.¹¹⁹</p> <p>Për secilin program studimi, institucioni disponon dhe mban statistika të lidhura me cilësinë në hyrje dhe dalje, punësimin gjatë dhe pas diplomimit, etj. Të dhënat janë të detajuara dhe në bazë të profileve për secilin program studimi. Të dhënat përmbajnë informacione mbi cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve si dhe informacion mbi punësimin e tyre.¹²⁰</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi UMIS shërben kryesisht për evidentimin e angazhimit të pedagogëve në lëndët që mbulojnë sipas secilit semestër, ndërsa e gjithë veprimtaria e lidhur me procesin e mësimdhënies dhe komunikimit me studentët mbështetet në platformën UET LMS. Sistemi MOODLE (UET LMS) bën të mundur që studenti në kohë reale të azhurnohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio vizive etj. Studenti ka mundësi të komunikojë nëpërmjet sistemit në forume të hapura me pedagogët si dhe kolegët e kursit që ndjek; të shikojë notat dhe pikët on-line nga kudo që ndodhet.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>UET, në kuadër të digjitalizimit të procesit të mësimdhënies, ka ndërtuar Sistemin e Menaxhimit të Mësimdhënies UET LMS. Sistemi i menaxhimit të mësimdhënies online (UET LMS) është standardi më bashkëkohor, i përdorur nga gjithë universitetet prestigjioze në botë, në informatizimin e procesit të mësimdhënies online. Aktualisht, sistemi UET LMS është azhurnuar më të gjithë informacionin bazë si: Janë regjistruar të gjithë studentët në lëndët e tyre përkatëse dhe kanë akses të plotë në literaturën e lëndëve që ndjekin por jo në materialet e lëndëve që nuk i përkasin; Janë regjistruar të gjitha lëndët që ofrohen në UET, në BA dhe MA, për çdo semestër; Janë regjistruar të gjithë pedagogët përgjegjës për çdo lëndë; Secili pedagog është regjistruar në sistem në lëndët e veta; Çdo pedagog mund të shohë vetëm lëndët e veta dhe të menaxhojë krejt lehtësisht gjithë literaturën e lëndëve përkatëse; Sistemi ofron mundësi për çdo lloj kërkese që pedagogu mund të ketë për organizimin e procesit të mësimdhënies, si p.sh.: caktimi detyrave të kursit, të gjitha llojet e vlerësimit për çdo tipologji, pyetësorë të ndryshëm, evente, forum diskutimi online mes studentëve dhe pedagogut, dhe shumë funksione të tjera; Sistemi jep mundësinë që përpara logimit çdo pedagog apo student të mund të shohë të gjitha lëndët që ofrohen në universitet; Sistemi mundëson pedagogëve auditim të plotë të gjithë aktivitetit dhe përdorimit të sistemin nga studentët.</p> <p>Sistemi UET-LMS lidhet kryesisht me procesin mesimor, dhe duke qënë se prej një viti aktiviteti akademik po zhvillohet online për shkak të Pandemisë, në UET po përdoret edhe sistemi Microsoft Teams që lidhet vecanërisht me mësimdhënien online. Gjithashtu, në çdo zyrë të stafit akademik dhe administrativ, në</p>

¹¹⁹ Dokumenti mbështetës nr. 9 - Dokumenti E-I. Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore

¹²⁰ Dokumenti mbështetës nr. 27 - Cilësia në hyrje dhe dalje DP Kontabilitet

	<p>kompjuterat përkatës gjendet databaza e Institucionit me emërtimin “Dokumenta UET”, ku secili anëtar i institucionit mund të aksesojë në kohë reale të dhëna lidhur me strategjitë, rregulloret, urdhërat administrativ, standartet, dhe çdo informacion dhe dokumentacion tjetër lidhur me aktivitetin e personelit akademik, ndihmës-akademik dhe partnerët e angazhuar në realizimin e programit.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Duke filluar nga viti akademik 2016-2017 UET ka vënë në përdorim platformën LMS (Learning Management System) për menaxhimin e mësimdhënies online. LMS është një aplikacion web për administrimin, dokumentimin, ndjekjen, raportimin dhe shpërndarjen e materialeve mësimore dhe informacionit tjetër të rëndësishëm për studentët. Ky sistem ofron informacion të personalizuar për çdo përdorues, student apo pedagog. Çdo student, apo pedagog që hyn në sistem, merr vetëm informacionin që i përket atij. Funkzioni kryesor i këtij sistemi është të lehtësojë komunikimin dhe shkëmbimin e materialeve të studimit dhe informacionit (njoftimet detyrat që duhen dorëzuar, afatet e dorëzimit, etj.) mes pedagogut dhe studentëve, duke ndihmuar në rritjen e cilësisë së mësimdhënies, pasi studenti merr përmes sistemit, gjithë bazën didaktike dhe orientimet e pedagogut për lëndën, si edhe ka mundësi t’i drejtojë atij pyetje për paqartësitë e mundshme</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Platforma LMS (Learning Management System) është edhe një mjet eficient në dispozicion të organeve drejtuese dhe titullarët, për të monitoruar mbarëvajtjen e procesit të akademik, përmes të dhënave statistikore të gjeneruara nga ky sistem. Në përfundim të çdo semestri nxirren statistikatat përkatëse për çdo pedagog në lidhje me përdorimin e LMS-së.</p> <p>Në kuadër të analizës së cilësisë së mësimdhënies dhe shërbimit ndaj studentëve, në UET analizohet aktivizimi i çdo pedagogu në platformën interaktive UET LMS dhe Microsoft Teams, për lëndët dhe grupet e veta. Personi përgjegjës (Zyra e IT e UET) për menaxhimin e platformës UET LMS dhe Teams, dërgon në fund të çdo semestri, Raportin mbi aktivitetin e pedagogut në platformat interaktive, duke mundësuar raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.¹²¹</p> <p>Platforma LMS (Learning Management System) është edhe një mjet eficient në dispozicion të Zyrës të Sigurimit të Cilësisë, për të monitoruar mbarëvajtjen e procesit akademik, përmes të dhënave statistikore të gjeneruara nga ky sistem.</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Në faqen web të UET www.uet.edu.al pasqyrohen informacione lidhur me të gjitha programet e studimit të ofruara nga institucioni, informacion lidhur me personelin akademik sipas fakulteteve dhe departamenteve përkatëse (kualifikimi dhe CV bio e personelit akademik)¹²² dhe çdo aktivitet në kuadër të veprimtarisë kërkimore shkencore, leksioneve të hapura si dhe leksioneve nga të ftuar të shquar të botës së biznesit dhe akademisë publikohen në rrjete sociale. Të gjitha këto</p>

¹²¹ Dokument mbështetës nr. 46.5 - Raport: ecuria e mësimin online

¹²² Të dhëna nga faqja zyrtare e WEB Informacione për stafin dhe CV bio e stafit akademik të programit të studimit <https://uet.edu.al/new/fakulteti-i-ekonomise-biznesit-dhe-zhvillimit/>

	informacione publikohen në faqen web të institucionit në dy gjuhë, në gjuhën shqipe dhe atë angleze.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin, në programin e studimit dhe i vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika, procedura dhe kriteret të pranimit, përparimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore dhe që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Procesi nga pranimi deri në dalje mbështetet në: legjislacionin në fuqi, statutin dhe rregulloret përkatëse ¹²³ , burimet njerëzore dhe kapacitetet infrastrukturore. Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit publikohet online ¹²⁴ , në broshurën informuese (Guida UET), fushatat informuese mediatike, si edhe gjatë këshillimit në institucion. Institucioni kujdeset që të ndjekë ecurinë e studentit gjatë gjithë procesit, duke hartuar dhe zbatuar politika dhe procedura. ¹²⁵ Kriteret dhe procedurat janë të kuptueshme dhe të aksesueshme, duke garantuar transparencë të plotë. Kriteret dhe procedurat janë të aksesueshme online, i bëhen të ditura të interesuarve gjatë vizitës në institucion, sikurse dhe gjenden në aktet rregullatore të cilat i vihen në dispozicion studentëve të aksesueshme dhe në intranetin e UET
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje dhe orientimin drejt tregut të punës, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Në përgjithësi politikat dhe procedurat e hartuara dhe që zbatohen në UET janë ngritur mbi parimet e barazisë dhe drejtësisë. Si të tilla, edhe kriteret dhe procedurat nga hyrja në dalje janë transparente për të gjithë, duke garantuar barazi dhe të drejta të barabarta për kandidatët dhe studentët e programeve të studimit.

¹²³ Dokumenti mbështetës nr. 27.1 - Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve

¹²⁴ <http://uet.edu.al/new/si-te-aplikojme/>

¹²⁵ Dokumenti mbështetës nr. 28 - Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin; Dokumenti mbështetës nr.12 - Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit; Dokumenti mbështetës nr. 27.2 - Dokumenti A-V Mbi tutoriatin, këshillimin akademik dhe këshillimin metodologjik; Dokumenti mbështetës nr. 7 - Rregullore mësimore DP Kontabilitet

	Gjithashtu, institucioni është mbështetës i kauzave kundër diskriminimit, qoftë ai racor, gjinor, fetar, etj.
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe, përpara fillimit të çdo viti akademik, udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	<p>Përpara çdo viti akademik institucioni harton dhe publikon kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programet e studimit me karakter profesional përfshirë DP Kontabilitet, të cilat janë në përputhje me ndryshimet e mundshme në legjislacionin përkatës.¹²⁶</p> <p>Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit nëpërmjet informacionit në website-n e tij, pritjes dhe informimit nga këshilluesit e karrierës, komunikimit me zyrën e pranimeve, takimeve me studentët potencialë (gjimnaz tour) etj.</p> <p>Në aktet rregullatore të UET, janë shprehur format me të cilat mund të realizohet udhëzimi i studentëve të ardhshëm:</p> <ol style="list-style-type: none"> Organizim i takimeve informuese, sqaruese dhe ndërgjegjësuere me gjimnazistë të gjimnazeve të Tiranës, të qyteteve të tjera të vendit dhe të Rajonit në mjediset e tyre; Organizimi i seminareve, i tryezave të rrumbullakëta, i leksioneve hyrëse dhe i veprimtarive të tjera me karakter mësimor-informues-argëtues me gjimnazistë të gjimnazeve të Tiranës, të qyteteve të tjera të vendit dhe të Rajonit në mjediset e UET-it; Përgatitje e materialeve informuese, sqaruese, ndërgjegjësuere si për shembull fletëpalosje, postera, broshura etj., dhe të atyre vizive si: spote televizive, mesazhe promocionale etj; Zyra e Pranimeve mban evidencat e personave të interesuar për të ndjekur studimet në UET. <p>Organizim logjistik, orientues, me mbështetje brenda burimeve njerëzore të UET-it për “Javët e Regjistrimit”, gjatë të cilave të interesuarit informohen, sqarohen, këshillohen mbi sistemin e studimeve, procedurat e aplikimit dhe të pranimit dhe gjithashtu pajisen me dokumentacionin përkatës.¹²⁷</p>
Kriteri 4. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.	I gjithë informacioni i plotë dhe i hollësishëm gjendet në rregulloren mësimore të programit të studimit ¹²⁸ dhe aktet e tjera rregullatore. Studentët njihen me rezultatet e tyre nëpërmjet platformave online UMS dhe LMS. Studentët e interesuar mund të tërheqin pranë koordinatores së Departamentit formularin e paradiplomimit, në të cilën gjenden të gjithë lëndët dhe rezultatet respektive, sikurse dhe statusi për çdo lëndë.
Kriteri 5. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit dhe	Kriteret dhe procedurat e vlerësimit i bëhen të ditura studentëve dhe parashikohen në rregulloren mësimore të programit të studimit. Ato janë pjesë e silabuseve të lëndëve, të cilat i vihen në

¹²⁶ Dokumenti mbështetës nr. 27.1 - Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve

¹²⁷ Dokumenti mbështetës nr. 51 - Politika e marketingut të programit të studimit

Dokument i mbështetës nr. 48 - Politika e prezantimit dhe promovimit të UET online

¹²⁸ Dokumenti mbështetës nr. 7 - Rregullore mësimore DP Kontabilitet

diplomimit në programin e studimit.	dispozicion dhe i shpjegohen studentëve që në fillim të procesit akademik ¹²⁹			
Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Në kuadër të fillimit të vitit të ri akademik, UET zhvillon Javën e Orientimit. Kjo është një traditë që UET e zhvillon çdo vit për të ndihmuar studentët e rinj që të njihen me programet, pedagogët, ambientet dhe disa nga rregullat bazë të universitetit. Mbledhjet e hapura të departamenteve shërbejnë gjithashtu për informimin dhe diskutimin me studentët lidhur me programet e studimit. Kriteret e programeve të studimit publikohen dhe i vihen në dispozicion palëve të interesuar nëpërmjet rrugëve dhe instrumenteve të ndryshme të komunikimit. ¹³⁰			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni informon në mënyrë të hollësishme studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit me karakter profesional.	Informacioni mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit i vihet në dispozicion studentëve nëpërmjet: <ul style="list-style-type: none"> • Këshillimit me stafin akademik në momentin që interesohen për programet e studimit; • Kontakteve me Zyrën e Kujdesit ndaj Studentit; • Rregullores mësimore të programit të studimit, dhe • Aktet e tjera rregullatore. Informacioni për programin dhe komponentët përbërës i vihen në dispozicion studentëve edhe në faqen online të institucionit si dhe në sistemin LMS. Silabuset e lëndëve shpërndahen përpara fillimit të çdo semestri dhe shpjegohen nga titullarët në orën e parë të leksionit për secilën lëndë.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Studentëve u mundësohet kryerja e stazhit në institucione të ndryshme me të cilat UET ka marrëveshje bashkëpunimi. Në këto institucione ata njihen me format dhe teknologjitë më të fundit dhe bashkëkohore, me qëllim përfitimin sa më të mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale që lidhen me këtë fushë në të cilën ata po studiojnë. <p>Institucioni i kushton një vëmendje të veçantë orientimit të studentëve drejt tregut të punës, nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, e cila e zhvillon veprimtarinë e saj në bashkëpunim të ngushtë me

¹²⁹ Dokumenti mbështetës nr. 19 – Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite

¹³⁰ Dokumenti mbështetës nr. 51 - Komunikimi i integruar i marketingut

Dokument i mbështetës nr. 48 - Dokumenti E.V. Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET online

	<p>këshilluesit e karrierës së çdo fakulteti/departamenti, si dhe duke u diferencuar në funksion të nivelit të studimit¹³¹;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bordeve të Tregut të Punës – të cilat shërbejnë si urë lidhëse midis universitetit dhe tregut të punës¹³²; • Organizimit të panairëve të punës dhe veprimtari me aktorë nga tregu i punës;¹³³ • Dërgimit të njoftimeve të studentët mbi mundësitë e ndryshme për punësim. 			
<p>Kriteri 3. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentët e fillojnë eksperiencën e tyre në UET me Javën e Orientimit që është një traditë që UET e zhvillon çdo vit për të ndihmuar studentët e rinj që të njihen me programet, pedagogët, ambjentet dhe disa nga rregullat bazë të universitetit. Në vazhdimësi studentëve u vihet në dispozicion akses në systemin LMS, në intranet si dhe së fundmi edhe në sistemin Microsoft teams ku ju mundësohet të marrin informacion të përditësuar në kohë reale në lidhje me procesin mësimor, kalendarin akademik dhe aktivitete të ndryshme mësimore që organizohen në UET. Gjithashtu, një nga detyrat e koordinatorëve të departamentit¹³⁴ është mbajtja e kontakteve të rregullta, njoftimeve elektronike dhe me telefon, me studentët që ndjekin programe studimi të Departamentit. Çdo ndryshim në orar, ose ndryshim gjatë zbatimit të tij, u njoftohet studentëve përmes njoftimeve të koordinatorëve të departamenteve dhe shpallet në këndin e njoftimeve. Çdo informacion tjetër, dërgohen përmes postës elektronike dhe sistemit LMS.</p>			
<p>Kriteri 4. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Programi i studimit, me lëndët përbërëse të tij, sipas viteve dhe semestrave është i publikuar në faqen e internetit të UET-it. Gjithashtu studentët në fillim të secilit semestër pajisen me të gjithë silabuset e lëndëve, ku jepen në detaje temat e lëndës, literatura kryesore, forma e kontrollit të dijeve, literatura e rekomanduar. Ky informacion është edhe pjesë e platformës LMS, ku çdo student sheh gjithë materialet e lëndës që pedagogët vendosin në portal, krahas silabusit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.3 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit me karakter profesional, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>

¹³¹ Dokumenti mbështetës nr. 12 - Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit

¹³² Dokumenti mbështetës nr. 12.1 dhe 12.2 - Bordi i Tregut të Punës 2018-2019 dhe 2019-2020

¹³³ Dokumenti mbështetës nr. 12.3 dhe 12.4 – Panairi i punës 2018 dhe 2019; Realitetet e reja post-covid, 2020

¹³⁴ Dokumenti mbështetës nr. 36.1 – Detyrat e kordinatorit të programit

<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në vitet paraardhëse në programin e studimit.</p>	<p>UET disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit Diplomë Profesionale në „Kontabilitet“¹³⁵. Nëpërmjet Zyrës së zhvillimit të karrierës dhe Shoqatës Alumni, në mënyrë periodike mbahen kontakte të vazhdueshme me ish-studentë me qëllim jo vetëm ndarjen e eksperiencave dhe arritjeve profesionale të gjithsecilit, por edhe krijimin e urave efektive lidhëse midis universitetit dhe tregut të punës.</p> <p>Ndryshe nga programet e tjera të studimit në Departamentin e Ekonomisë dhe Financës¹³⁶, në DP Kontabilitet janë diplomuar (kanë shlyer detyrimet akademike) vetëm një brez i studenteve. Brezi i radhës do të jenë të diplomuarit e vitit akademik 2020-2021. Për çdo brez të diplomuarish, UET mban statistika vjetore për cilësinë në hyrje dhe në dalje.¹³⁷</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Institucioni disponon statistika të plota mbi ecurinë e studentëve në secilin program studimi. Përsa i përket programit Diplomë Profesionale në Kontabilitet, në tre vitet e para të tij kemi respektivisht 7 regjistrime në vitin e parë, 26 regjistrime në vitin e dytë dhe 5 regjistrime në vitin e tretë të tij.¹³⁸</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre, përfshirë punësimin eventual të tyre.</p>	<p>Çdo student ka dosjen e tij, ku përmbahen të gjitha të dhënat; nga momenti i regjistrimit e deri pas diplomimit. Këto të dhëna gjenden në Sekretarinë Mësimore dhe në Zyrën e Regjistrimit të Studentëve¹³⁹.</p>			
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Universitetit (UMIS) është një program informatik i cili është krijuar për të realizuar ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të studentit, atyre akademike, prodhimin e raporteve statistikore si dhe menaxhimin e aspekteve të funksionimit të Universitetit, si: financat studentore, veprimtarinë e Bibliotekës, etj. Përmbajtja e informacioneve/njoftimeve që lidhen me UMIS administrohen nga personi pranë Zyrës IT-së me detyrë funksionale menaxhimin teknik të sistemit UMIS.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Zyra e Këshillimit të Karrierës mban kontaktet me studentët e diplomuar nëpërmjet strukturës së UET Alumni dhe harton raporte periodike mbi cilësinë në dalje dhe shkallën e punësimit të studentëve. Programi profesional DP në Kontabilitet duke qenë një program i ri ka të dhëna të në numër të ulët mbi këtë kriter, pasi numri i të diplomuarve është shumë i vogël.¹⁴⁰</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Nuk</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet</p>

¹³⁵ Dokumenti mbështetës nr. 29 – Tabelë përmbledhëse për punësimin real të studentëve

¹³⁶ Dokumenti mbështetës nr. 26 - Të dhëna për numrin e programeve që ofrohen njësia përgjegjëse

¹³⁷ Dokumenti mbështetës nr. 27 - Cilësia në hyrje dhe në dalje DP Kontabilitet

¹³⁸ Dokumenti mbështetës nr. 27 - Cilësia në hyrje dhe dalje DP Kontabilitet

¹³⁹ Dokumenti mbështetës nr. 27 - Cilësia në hyrje dhe dalje DP Kontabilitet

Dokument mbështetës nr. 9 - Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore

¹⁴⁰ Dokumenti mbështetës nr. 29 – Tabelë përmbledhëse mbi punësimin real të studentëve

standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Studentët përfaqësohen në organet drejtuese të institucionit, në strukturat mësimore-kërkimore dhe të shërbimeve. UET-i inkurajon pjesëmarrjen e studentëve në vendimmarrje, organizimin e lirë, dhe shprehjen e mendimit të tyre ¹⁴¹ . Ndër strukturat kryesore përmendim: <ul style="list-style-type: none"> • Këshilli i Studentëve - realizon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese. • Senati Akademik –ka përfaqësues të studentëve. • Këshilli Etikës - një anëtar i rekomandohet Rektorit nga Këshilli i Studentëve. • KSBC – ka një anëtar përfaqësues nga Këshilli i Studentëve. • Mbledhjet e departamenteve, një në muaj është e hapur për studentët.
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose e përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Përfshirja e studentëve garantohej, si në mënyrë të drejtpërdrejtë (përfaqësimi në strukturat e analizuar në Kriterin 1), ashtu edhe në mënyrë periodike, nëpërmjet zhvillimit të fokus-grupeve, pyetësorëve online dhe kërkesave të studentëve. Të dhënat e mbledhura nga këto instrumente, janë pjesë e diskutimeve në nivel drejtues të institucionit, me qëllim evidentimin e situatës dhe marrjen e masave për përmirësim të vazhdueshëm. Një student i programit DP në Kontabilitet është pjesë e GVB të ngritur në kuadër të hartimit të këtij raporti.
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	Programet e studimit i nënshtrohen në mënyrë periodike rishikimit në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm, bazuar në parashikimet ligjore në fuqi. Shpërndarja e lëndëve nëpër semestra dhe ngarkesës së shprehur në kredite bëhet mbi parimin e një shpërndarje të balancuar në semestra. Në programin DP në Kontabilitet, në semestrin e parë studentët ndjekin 4 lëndë, dhe nisin punën për punimin e diplomës, ndërsa në semestrin e dytë 3 lëndë, duke qenë se i krijohen lehtësira për tu angazhuar në praktikën profesionale dhe detyrimet përmbyllëse të programit. ¹⁴²
Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Zhvillimi i fokus-grupeve, pyetësorëve online dhe mbledhjeve të hapura të departamenteve shërbejnë si instrumente për të matur perceptimin e studentëve në raport me programin e studimit në tërësi. Gjetjet e tyre, bëhen pjesë e diskutimeve dhe mund të shoqërohen me ndryshime në programin e studimit.

¹⁴¹ Dokumenti mbështetës nr. 2 - Statuti UET, Neni 16, 19 dhe 51

¹⁴² Dokumenti mbështetës nr. 14.1 – Plani mësimor i programit DP në Kontabilitet

Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Mënyra e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve është një proces transparent, i cili shprehet në rregulloret e brendshme ¹⁴³ sikurse dhe në silabusin e secilës lëndë ¹⁴⁴ . Sekretimi i provimeve, argumentimi i vlerësimit nga pedagogu, zhvillimi i seancave sqaruese dhe mundësia e kërkesës për rivlerësim nga një komision i posaçëm, janë tregues të transparencës dhe barazisë së procesit të vlerësimit. Studentët kanë mundësi të parashitrojnë kërkesat e tyre duke plotësuar formularët përkatës. ¹⁴⁵			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Njësia e posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve në UET është zyra e Kujdesit ndaj Studentit. ¹⁴⁶ Kjo zyrë ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij, duke ofruar konsulencë për çështje akademike dhe studentore. Tutoriati dhe këshillimi akademik, sikurse dhe këshilluesit e karrierës në çdo Departament janë gjithashtu në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve ¹⁴⁷ .
Kriteri 2. Në institucion është ngritur dhe funksionon një sistem i posaçëm për mirëpritjen, informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Kombinimi i veprimtarisë së zyrave administrative dhe sistemit të këshillimit në bazë të secilit departament (referencë kriteri 1), janë tregues të ngritjes dhe mirëfunksionimit të një sistemi të përshtatshëm të informimit, këshillimit dhe asistencës së vazhdueshme për studentët. UET ka një sistem të veçantë për mirëpritje (zyra e pranimeve) informimin, këshillimin, ndjekjen, asistimin (Zyra e kujdesit ndaj studentëve, Zyra e zhvillimit të karrierës, Zyra e projekteve dhe partneriteteve) (këshilluesit akademik, sekretaria mësimore, koordinatorët e departamenteve, regjistruerit e lëndëve, etj) e studentëve për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Kjo bëhet kryesisht nëpërmjet zyrës së kujdesit ndaj studentëve, si edhe njësive të tjera, por edhe me anë të sistemit UET LMS dhe Microsoft Teams ku ofrohen informacione të përditësuara për procesin mësimor dhe programin e studimit. Informimi i studentëve realizohet edhe nëpërmjet email-it, që shërben si një mjet tjetër për informim dhe këshillim nga individët dhe njësitë përgjegjëse.
Kriteri 3. Përmes zyrës/njesisë për	Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit ndjek

¹⁴³ Dokumenti mbështetës nr. 5 - Rregullore e UET, Neni 24, 27 dhe 32

¹⁴⁴ Dokumenti mbështetës nr. 19.1 - Formati i silabusit cikli i pare dhe dytë

¹⁴⁵ Dokumenti mbështetës nr. 40.1 - D-VI-3-3 Formular për ankesat e studentëve

¹⁴⁶ Dokumenti mbështetës nr. 12 - Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit

¹⁴⁷ Dokumenti mbështetës nr. 27.2 - Dokumenti A-V Mbi tutoriatin, këshillimin akademik

<p>këshillimin e karrierës, institucioni mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm lidhur me plotësimin e detyrimeve të procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij, sikurse ruan edhe kontaktet pas diplomimit, duke ofruar konsulencë për çështje akademike dhe studentore. Ky shërbim nuk zëvendëson këshillimin që jepet nga personeli akademik gjatë orëve të tutoriatit dhe këshillimit akademik, por janë plotësues.</p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit, ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse dhe merr masa për përmirësimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre.</p>	<p>Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit mban kontakte me studentët e diplomuar duke krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre apo vazhdimin e studimeve në UET ose institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. Që nga viti 2009, kur u diplomuan studentët e parë, në UET është ngritur edhe shoqata UET Alumni, me përfaqësuesit e së cilës zhvillohen takime të vazhdueshme, për të vjelur mendime lidhur me përmirësimet e mundshme që do të duhet të bëhen në organizimin dhe ofertën akademike të institucionit për t'iu përshtatur më mirë kërkesave të tregut të punës dhe zhvillimeve bashkëkohore në vend e më gjerë¹⁴⁸. Në këtë kuadër, studentë Alumni janë të përfshirë në Bordet e Tregut të Punës pranë Departamenteve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

¹⁴⁸ <http://uet.edu.al/new/uet-alumni-10-vite-me-pas/>

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional “Kontabilitet” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti European i Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Mësimdhënia e mbështetur në metoda bashkëkohore dhe sistem *e-learning*, në shërbim të studentëve dhe personelit akademik.
2. Cilësia e personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie, i cili ka grada e tituj, konform përcaktimeve ligjore, eksperiencë në mësimdhënie dhe përvojë profesionale në fusha të ndryshme të financës.
3. Bashkëpunimi i ngushtë me aktorët e tregut të punës, dhe përfshirja e tyre në procesin e rishikimit të programeve të studimit, apo në mësimdhënie si lektorë të ftuar për tema specifike të ekspertizës së tyre profesionale, sjell një harmonizim mjaft të mirë të njohurive teorike me ato praktike dhe bën që programi t’i përgjigjet më mirë kërkesave të tregut të punës. Njëkohësisht, ky bashkëpunim lehtëson punësimin e studentëve pas diplomimit.
4. Zhvillimi dhe rritja e mundësive për t’u përfshirë në projekte ndërkombëtare, për shkëmbim eksperience dhe zhvillim kapacitetesh. Personeli akademik, administrativ dhe studentët, kanë gjithnjë e më shumë mundësi për të përfituar nga bashkëpunimi në rritje me institucionet partnere ndërkombëtare, në kuadër të projekteve që menaxhohen nga Zyra e Projekteve dhe Partneriteteve.

Pika të dobëta

1. Nga vetë natyra dhe kriteret në hyrje programet me karakter profesional për zgjidhen nga studentë me mesatare të ulët dhe si pasojë performanca e tyre në këtë program studimi përbën një sfidë, sidomos për lëndët me koncepte matematikore.
2. Një aspekt problematik dhe pengues për përmbushjen optimale të objektivave të këtij programi është lidhja ende e dobët dhe jo shumë organike, me përfitim të dyanshëm, me operatorët e biznesit dhe organizatat e tjera që operojnë në treg. Gjatë vitit të fundit kjo është ndikuar dhe nga situata e shkaktuar prej pandemisë globale, Covid-19.
3. Vështirësia e pritshme e punësimit të tyre, për shkak të konkurrencës nga studentët cikleve të tjera të studimit, për të njëjtën veprimtari pune. Megjithatë, numri i të diplomuarëve në programin e studimit ka qënë i ulët gjë që ndikon kryerjen e analizave më të plota të treguesëve të punësimit.

Lista e dokumenteve mbështetëse për procesin e akreditimit të programit të studimit me karakter profesional në “Kontabilitet”

1. Mendimi i Dekanit
2. Statuti i UET
3. Plani Strategjik UET 2015-2020
 - 3.1. Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020
 - 3.2. Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025
 - 3.3. Plani Strategjik UET 2021-2025
4. Plani Strategjik për zhvillimin e programit
5. Rregullore e UET
 - 5.1 Vendim_Mbi zhvillimin e procesit akademik ne situaten e krijuar nga pandemia COVID-19 dhe Mbi lëshimin e diplomave
 - 5.2 Rregullore tranzitore_Mbi vijimin e procesit akademik gjatë semestrit të parë të vitit akademik 2020-2021 në kushtet e pademisë COVID-19
 - 5.3 Rregullore tranzitore_Per zhvillimin e procesit akademik gjate Vitit Akademik 2020-2021
6. Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit
7. Rregullore e programit të studimit DP Kontabilitet
 - 7.1. Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve
 - 7.2. Format i tezës së provimit përfundimtar
8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë
9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore
10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit
 - 10.1. Kalendari akademik 2018-2019
 - 10.2. Kalendari akademik 2019-2020
 - 10.3. Kalendari akademik 2020-2021
11. Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore
 - 11.1. Shembull thirrje për staf akademik
12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit
 - 12.1. Bordi i Tregut të Punës 2018-2019
 - 12.2. Bordi i Tregut të Punës 2019-2020
 - 12.3. Poster_Panairi i punës 2018 dhe 2019
 - 12.4. Realitetet e Reja të Post-Covid 19 në Tregun e Punës 2020
 - 12.5. Bashkëpunime me biznesin – Projekti 500+
13. Dokumenti E.VIII Mbi funksionimin e Zyrës së Kurrikulave
14. Kurrikula e programit – DP Kontabilitet
 - 14.1. Plani mësimor i programit – DP Kontabilitet
 - 14.2. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – DP Kontabilitet
 - 14.3. Plani mësimor sipas veprimtarive me karakter praktik – DP Kontabilitet
15. Modeli i diplomës (**Urdhëri i aprovimit – urdhër nuk ka, pritet akreditimi**)
16. Argumentimi për hapjen e programit
17. Analizë e tregut të punës për prespektivat e programit

18. Adresimi i rekomandimeve të hapjes
19. Syllabuset e lëndëve të ofruara
 - 19.1. Formati i Syllabusit
20. CV e stafit akademik të programit të studimit
21. CV e stafit akademik udhëheqës i diplomave (në rastin kur nuk është pjesë e stafit akademik të programit **(nuk ka)**)
22. CV e stafit ndihmës akademik **(nuk ka)**
23. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse (Aneks Tabelat 1 dhe 2)
24. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin studimit ndër vite (Aneks Tabelat 6; 7; 8; 12)
25. Ngarkesa mësimore në auditor e stafit akademik, të angazhuar në programin e studimit (Aneks Tabela 4)
26. Të dhëna për numrin e programeve që ofrohen nga njësia përgjegjëse
27. Cilësia në hyrje dhe dalje për programin
 - 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve
 - 27.2. Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik
28. Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin
29. Tabelë përmbledhëse për punësimin real të studentëve
30. Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC
 - 30.1. Plani veprimit KSBC
 - 30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë
 - 30.3. Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë
 - 30.4. Urdhër administrativ mbi përbërjen e KSBC
 - 30.5. Metodologjia e punës së aktiviteteve të KSBC
 - 30.6. Format_Raporti për provimet
 - 30.7. Shpërndarja e relacionit të KSBC mbi silabuset
 - 30.8. G-III-4-1 Formulari i vleresimit të pedagogut nga eprori-kolegu
 - 30.9. Fisha e projektit Enchase
 - 30.10. Fisha e projektit QAinAL
31. Të dhëna për kodifikimin e programit të studimit (mbështetur në LAL 80/2015), apo Udhëzimeve Kombëtare e Europiane **(nuk kanë dalë ende aktet nga MASR)**
32. Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikat profesionale (Aneks Tabela 5)
 - 32.1 Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale
 - 32.2 B-I-4 Formulari i vetëvlerësimit të praktikës (nga Studenti)
33. Trajnime profesionale
 - 33.1 Kalendar i aktiviteteve
34. Lista e marreveshjeve të bashkëpunimit_ UET
 - 34.1 Marreveshje bashkëpunimi_ UET dhe ITD
 - 34.2 Marreveshje bashkëpunimi_ UET dhe AWARD GROUP
 - 34.3 Marreveshje bashkëpunimi_ UET dhe E.H.W.

- 34.4 Marreveshje bashkepunimi_UET dhe Infosoft
- 34.5 Marreveshje bashkepunimi_UET dhe Balfin
- 34.6 Marreveshje bashkepunimi_UET dhe Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare
- 34.7 Marreveshje bashkepunimi_UET dhe WE WEB
- 34.8 Marreveshje bashkepunimi_UET dhe Dhoma e Tregetise dhe Industrise
- 34.9 Marreveshje bashkepunimi_UET dhe INSTAT
- 34.10 Marreveshje bashkepunimi_UET dhe AKH
- 35. Raport analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit
- 36. Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit (**legjislacioni nuk parashikon Koordinator të programeve të studimit me karakter profesional**)
- 37. Format relacioni për vlerësimin e përputhshmërisë së silabuseve
- 38. Analiza e departamentit përgjegjës për përmbushjen e objektivave formues të programit
- 39. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës
- 40. G-III-4-2 Format i vlerësimit të pedagogut nga studentët
 - 40.1 D-VI-3-3 Formular për ankesat e studentëve
- 41. G-I-12-1 Formular i vetevlerësimit të performancës së personelit akademik
- 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit
- 43. Të dhëna mbi kërkimin shkencor të stafit akademik 2018-2019
 - 43.1 Të dhëna mbi kërkimin shkencor të stafit akademik 2019-2020
 - 43.2 Pjesëmarrja në projekte 2018-2019
 - 43.3 Pjesëmarrja në projekte 2019-2020
 - 43.4 Trajnimi mbi sistemin UET LMS
- 44. Format Dosje staf akademik (**administrohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore, sipas PAK/PAE**):
 - 44.1 Format dosje staf akademik me kohë të plotë
 - 44.2 Format dosje staf akademik me kohë të pjesshme
- 45. Inventari i teksteve për fushën e programit të studimit
 - 45.1 Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës
 - 45.2 E-IV-2 Formular për pasurimin e fondit të librave në bibliotekë
 - 45.3 Shembull procedure_blerje literature
- 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS
 - 46.1 Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS
 - 46.2 UET LMS Guide për pedagogun
 - 46.3 UET LMS Guide për studentet
 - 46.4 Video-trajnime mbi sistemin TEAMS/LMS

46.5 Raport: ecuria e mësimit online

47. Faqja zyrtare e Universitetit European të Tiranës www.uet.edu.al; <https://uet.edu.al/new/fakulteti-i-ekonomise-biznesit-dhe-zhvillimit/>
48. Dokumenti E.V. Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET online;
49. Të dhëna mbi koston për student (Aneks Tabela 18.1)
50. Të ardhura dhe financime të ndryshme (Aneks Tabela 18.2)
51. Politika e marketingut të programit të studimit
52. Procedura për ndryshimin e kurrikulës (**Nuk ka – program i ri**);
53. Ligji 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH”
 - 53.1 VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit”, e ndryshuar
 - 53.2 VKM Nr. 531, datë 11.06.2018 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”
54. UMASR Nr. 545, datë 10.09.2018 “Për hapjen e programit DP Kontabilitet, UET”
 - 54.1 VKM Nr. 636, datë 20.09.2006 “Për hapjen e UET”
 - 54.2 UMASR Nr. 527, datë 04.09.2018 “Për riorganizmin e FETI në FEBZH në UET”
 - 54.3 VBA Nr. 12, datë 07.04.2017 “Për akreditimin institucional të UET”
 - 54.4 VBA Nr. 46, datë 05.07.2019 “Për akreditimin e UET”
 - 54.5 Certifikatë Akreditimi UET
55. Ditët e Studimeve Shqiptare (DSSH)
56. A.II. Kodi i Etikës